

RAPORT PËRMBLEDHËS: MONITORIMI I PROVIMIT TË MATURËS SHTETËRORE 2020

Titulli: Raport përbledhës: Monitorimi i Provimit të Maturës Shtetërore 2020

Autor/e: Agnesa Qerimi

Dizajni: BubaGraphics L.L.C

Këshilli Rinor Kosovar

Rruga Sejdi Kryeziu nr. 58

Prishtinë 10000, Kosovë

kyckosova@gmail.com

+383 (44) 96 45 75

2020 (C) Të gjitha të drejtat e rezervuara. Këshilli Rinor Kosovar (KYC).

Ky dokument është pronë e Këshillit Rinor Kosovar, andaj çdo kopjim, përdorim i plotë apo i pjesshëm i materialit pa cituar burimin apo pa lejen paraprake të KYC nuk lejohet.

Ky raport është përgatitur në kuadër të projektit “*Fuqizimin e Këshillit të Nxënësve të Kosovës*”, me mbështetje nga Friedrich Ebert Stiftung, Schuler Helfen Leben, Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe implementuar nga KYC. Pikëpamjet e shprehura në këtë dokument janë ato të autorit, dhe nuk pasqyrojnë medoemos qëndrimet e donatorëve.

Tabela e përbajtjes

Hyrje	7
1.1 Mirënjojhe.....	9
Rëndësia e monitorimit të provimit të maturës shtetërore.....	12
2.1 Metodologja.....	14
Monitorimi në terren	18
3.1 Mbarëvajtja e procesit të provimit të maturës shtetërore - Të dhënat dhe statistikat e dala nga monitorimi në terren	19
Këndvështrimi i kandidatit/ës	35
4.1 Parapërgatitjet për provimin e maturës shtetërore	36
4.2 Seksion i integruar i pyetësorit: sa të vërteta janë deklaratat më poshtë	45
4.3 Mbarëvajtja e procesit të provimit të maturës shtetërore.....	47
Rekomandime	58
Lista e dokumenteve të referencës.....	59
Formularët	60
Provimi i maturës shtetërore 2020	60
Forma e raportimit të monitoruesit/es të maturës.....	64
Këndvështrimi i maturantëve/provimi shtetëror i maturës 2020	65
Raportimet për testin e maturës.....	68

Shkurtesat

MASH – Ministria e Arsimit dhe Shkencës

KSHM – Komisioni Shtetëror i Maturës

DVSM – Divisioni për Vlerësim, Standarde dhe Monitorim

DKA – Drejtoria Komunale e Arsimit

KYC – Kosovar Youth Council - Këshilli Rinor Kosovar

KNK – Këshilli i Nxënësve të Kosovës

IKSHPK – Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës

ISCED – Standardet Ndërkombëtare të Klasifikimit të Arsimit

SHML - Shkolla e Mesme të Lartë

SHL - Schuler Helfen Leben

FES - Friedrich Ebert Stiftung

OJQ – Organizatë Jo – Qeveritare

01

Hyrje

RAPORT PËRMBLEDHËS: MONITORIMI I PROVIMIT TË MATURËS SHTETËRORE 2020

Provimi i Maturës Shtetërore – është proces i mbledhjes, përpunimit, analizimit, vlerësimit dhe i interpretimit të dhënavë me qëllim të përcaktimit të shkallës së njohurive dhe zotërimit të kompetencave të përcaktuara me kurrikulë, saktësisht i përcaktuar kësijoj sipas LIGJI. Nr. 05/L – 018 Për Provimin e Maturës Shtetërore (në vazhdim “**Ligji për Provimin e Maturës Shtetërore**”).

Rrjetimisht, është përcaktues i shkallës së njohurive të arritura përgjatë mësim-nxënies në institucion arsimor dhe aftësues që realizon shërbime arsimore të nivitet 3 sipas Standardeve Ndërkombëtare të Klasifikimit të Arsimit – ISCED, apo ndryshe niveli i Arsimit para-universitar.

Duke pasur parasysh rëndësinë e tij vlerësuese, Këshilli Rinor Kosovar – KYC si organizatë jo-qeveritare kontribuon për **8 vitesh periudhë kohore**, vazhdimesht në monitorimin e mbarëvajtjes së Provimit të Maturës Shtetërore, duke ofruar kështu përmbledhje krahasuese të çështjeve teknike dhe administrative dhe rekomandime për përmirësim të cilësisë së mbarëvajtjes së Provimit të Maturës Shtetërore. Këshilli Rinor Kosovar në bashkëpunim me hisedarët përgjegjës institucional të organizimit të këtij Provimi mëton të pasqyroj përbushjen e dispozitave ligjore, mbajtjen e provimit, të drejtave të kandidatit/es, procedurave teknike dhe administrative të Provimit të Maturës Shtetërore, përbajtjes së Provimit të Maturës Shtetërore, ndjekjen e kritereve dhe rregullave të përcaktuara nga Divizioni për Vlerësim, Standarde dhe Monitorim (në vazhdim “**DVSM**”), detyrave dhe përgjegjësive të Komisionit në qendrat e testimit, administrueseve/ëve dhe mbikëqyrësve/eve.

Kësijoj, rëndësia e monitorimit të Provimit të Maturës Shtetërore qëndron me bazë në pasqyrim të standardeve të vendosura dhe mbarëvajtjes së Provimit karshi standardeve të vendosura dhe në të njëjtën kohë është pjesë e programit vjetor të Këshillit të Nxënësve të Kosovës (në vazhdim “**KNK**”) që është struktura më e madhe përfaqësuese e nxënësve/eve, e themeluar në vitin 2005. Kjo strukturë përfaqëson të gjithë nxënësit/et e shkollave të mesme dhe shërben si entitet që mbron të drejtat dhe interesat e të gjithë nxënësve duke bashkëpunuar me hisedarë si zyrtarë, prindër, mësimdhënës/e për të përfituar kështu përgjithësisht sistemi i edukimit. Motivi i themelimit të kësaj strukture nga Këshilli Rinor Kosovar – KYC buron nga neni 18, paragrafi 1 dhe 2 Ligji Nr. 04/L-032 Për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës (në vazhdim “**Ligji për Arsimin Parauniversitar**”) që përcakton se “*Këshilli drejtues i çdo shkolle të nivitet 2 dhe 3 të ISCED-it themelon një këshill të nxënësve, i cili duhet të ketë së paku një nxënës të zgjedhur nga secila klasë dhe që zgjidhet çdo vit përmes votës së fshehtë*” dhe që “*Roli i Këshillit të nxënësve është të punojë në përmirësimin e mjedisit mësimor, kushteve të punës dhe interesave që kanë të bëjnë me shëndetin, sigurinë dhe mirëqenien e nxënësve si dhe të përfaqësohen në këshillin drejtues.*” Rrjetimisht, Këshilli i Nxënësve të Kosovës si strukturë përfaqësuese e të gjitha Këshillave të Nxënësve të shkollës funksionon nën ombrellën e Këshillit Rinor Kosovar.

RAPORT PËRMBLEDHËS: MONITORIMI I PROVIMIT TË MATURËS SHTETËRORE 2020

Përkitazi me të, Monitorimi i Provimit të Maturës Shtetërore, është pjesë e planit të veprimit dhe planit strategjik të Këshillit Rinor Kosovar në kuadër të Programit të Edukimit që ndër të tjera mëton: **“Arritet e nxënësve dhe arsimimi cilësor janë thelbësore për suksesin afatgjatë të zhvillimit, të mundësimit të një jete të shëndetshme dhe kualitative, dhe të punësimit të rinjve/rejave. Përmes punës në edukim dhe në procese të avokimit dhe politikë-bërjes, KYC aspiron të ngrisë zërin e të rinjve/rejave dhe të ndikojë në rolin vendim-marrës në formësimin e politikave arsimore”**. Prandaj, Monitorimi i Provimit të Maturës Shtetërore është komponentë shumë e rëndësishme për rritjen e cilësisë së arsimit si një mjet që matë dijen e dhënë, pra përtej si proces procedural e administrativ, rezultatet dhe mbarëvajtja e tij japin si informatë dhe perspektivën, dhe nivelin e cilësisë së sistemit arsimor përgjithësisht.

1.1 Mirënjohje

Këshilli Rinor Kosovar - KYC, me një sfond njëzet (20) vjeçar kontributi në komunitet, themeluar që nga viti 1999 priorizon rininë, nevojën, sfidën dhe potencialin për rritje kapacitetesh të tyre prandaj dhe puna që zhvillon në komunitet si qëllim specifik strategjik ka dhe përmirësimin e cilësisë së arsimit për shkolla filllore dhe të mesme dhe këtë qëllim e fuqizon përmes tentimit të zhvillimit të partneritetit me palët e interesit për të përmirësuar cilësinë e arsimit për shkollat filllore dhe të mesme. Kështu që për ta bërë të mundshëm monitorimin e Provimit të Maturës Shtetërore, KYC ka angazhuar ekipin e tij plotësisht, të cilët/at kanë ndihmuar në realizimin e mundësisë dhe organizimin e monitorimit.

Rrjedhimisht KYC njehë kontributin e ekipit të tij dhe vullnetarëve/eve aktiv të organizatës si dhe njeh kontributin, e monitorueseve/ëve të terrenit të cilat/ët ndër të tjera janë angazhuar vullnetarisht për monitorim të testit përkundër organizimit të tij në një situatë të pakëndshme pandemie.

Dyzet e pesë (45) vullnetarët e angazhuar ishin:

Majlinda Avdiu	Diellza Asllani	Bajram Mehmeti
Erisa Lipoveci	Leona Jahiri	Liridon Kurti
Pranvera Zenuni	Samir Selmani	Drenusha Halilaj
Genta Uruqi	Riad Spahiu	Jetelira Podrimaj
Antonja Salihu	Resul Gashi	Fatmir Tolaj
Donika Zogu	Minir Fetahu	Alberim Berisha
Diellza Morina	Fexhrije Sylejmani	Naman Mehmeti
Vjosa Asllani	Edon Morina	Dardana Fetahu
Nisa Krasniqi	Rea Ukaj	Adisa Gerdella
Donarta Fetahu	Era Hyseni	Gresa Klinaku

RAPORT PËRMBLEDHËS: MONITORIMI I PROVIMIT TË MATURËS SHTETËRORE 2020

Arben Rahmani	Drin Syla	Agnesa Asllani
Verona Selimi	Blend Lahu	Shqipdona Zogjani
Shkurte Gashi	Butrin Lumi	Elit Hoti
Rina Morina	Mensur Fetahu	Durim Leci
Blina Salihu	Agnesa Qerimi	Elitë Bardha

Monitorimi i Provimit të Maturës Shtetërore është bërë i mundshëm dhe në bashkëpunim me **Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës** të cilët ia kanë besuar dhe aprovuar monitorimin Këshillit Rinor Kosovar. Monitoruesit/et janë angazhuar në bashkëpunim me Komisionin Shtetëror të Maturës (në vazhdim “**KSHM**”) dhe DVSM-në. Detyrat dhe të drejtat e monitorueseve/ëve të Këshillit Rinor Kosovar janë përcaktuar paraprakisht nga DVSM dhe KSHM, gjersa çdo monitorues/ese ka qenë i/e pavarur në raportimin për rrjetdhën e tërë procesit të Provimit të Maturës Shtetërore.

Ndër të tjera, Monitorimi i Provimit të Maturës Shtetërore është mbështetur dhe nga partnerë dhe donatorë të Këshillit Rinor Kosovar.

Organizimi i Monitorimit në terren të Provimit të Maturës Shtetërore është mbështetur nga **Friedrich Ebert Stiftung – FES** selia në Kosovë, përderisa i tërë projekti për “Fuqizimin e Këshillit të Nxënësve të Kosovës” në kuadër të së cilit realizohet ky monitorim, përkatësisht publikimi i raportit të monitorimit të Provimit të Maturës Shtetërore mbështetet nga **Schuler Helfen Leben – SHL**.

Raporti i Monitorimit të Provimit të Maturës Shtetërore është përpiluar nga Agnesa Qerimi - Njohëse e fushës së Arsimit Para-universitar në Kosovë.

02

Rëndësia e monitorimit të provimit të maturës shtetërore

RAPORT PËRMBLEDHËS I MONITORIMIT I PROVIMIT TË MATURËS SHTETËRORE

Provimi i Maturës Shtetërore është proces i rregulluar me bazë ligjore në Ligjin për Provimin e Maturës Shtetërore, dhe akteve të tjera nënligjore. Kësisoj, duke konsideruar rëndësinë shtetërore të tij krahas vlerësimit të mësim-nxënies dhe mësim-dhënies bazuar në Kurrikulë, Këshilli Rinor Kosovar për vite të tëra bëhet aleat i procesit duke monitoruar provimin në terren, përfshirë një numër të madh të qendrave të testimit.

Përkundër bazës ligjore ku përcaktohet saktësisht rëndësia, roli i secilit hisedarë, dhe mbarëvajtja, Provimi i Maturës Shtetërore vit pas viti pëson ndryshime, procesive dhe administrative. Këtë vit ndër të tjera, procesi i Provimit të Maturës Shtetërore është përballur dhe me sfidën e organizimit në një kohë pandemie siç ishte sfida e krijuar nga virusi Covid-19. Organizimi në bazë të rr Ethanave dhe kushteve më të përshtatshme shëndetësore por dhe roli dhe përgjegjësitë e secilit hisedarë në Provimin e Maturës Shtetërore përgjithësisht, u udhëzua përmes: a) Udhëzuesit për Maturën Shtetërore” – MASH, DVSM, KSHM dhe b) Informata, udhëzime dhe rregulla për kandidatët (maturantët) për provimin e maturës shtetërore 2020 (në vazhdim “**Udhëzime, Rregulla për kandidatët/et**”) – KMSH.

Rrjedhimisht, sipas Udhëzueseve të lartpërmendur, elementet përbajtjesore të procesit të Provimit të Maturës Shtetërore të vitit 2020 ishin:

- Pragu i kalueshmërisë: 40 % e totalit të pikëve të mundshme;
- Provimi i Maturës Shtetërore mbahet më 4 korrik 2020 (me vendim të Ministrit Likaj pastaj është shtyer për 29 gusht 2020), në të njëjtën kohë për të gjithë kandidatët/et, në përputhje me rekomandimet e Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës (në vazhdim: “**IKSHPK**”);
- Numër sa më të vogël të kandidatëve/eve brenda një qendre të testimit dhe brenda klasave të testimit;
- Provimi i Maturës Shtetërore mbahet brenda një dite për të gjitha lëndët dhe të gjithë/a kandidatët/et;
- Testi ka 100 kërkesa (pyetje, detyra), 25 kërkesa për lëndë;
- Testi zgjatë 150 minuta;
- Lëndët e përfshira: Gjuhë amtare, Gjuhë angleze dhe Matematikë si lëndë bazë dhe një lëndë zgjedhore që përzgjidhet nga vet kandidati/ja.

Komisioni Shtetëror i Maturës – KSHM përmes një **Komunikatë të 28 gusht 2020** ka bërë të ditur që për vitin 2020, Provimit të Maturës Shtetërore do ti nënshtrohen **26,669 maturantë**. Përderisa Testi i Maturës do të organizohet në **184 qendra të testimit**, në **30 komuna** të **Kosovës** dhe për mbarëvajtjen e procesit janë angazhuar **2.568 administrues, 570 komisionerë, 570 mbikëqyrës** dhe **3 mësimdhënës** për secilën qendër.

Sipas kapitullit 7 – Monitoruesit -të Udhëzuesit për Maturën Shtetërore, “Monitoruesit dërgojnë kërkesën në MASH/DVSM një (1) javë para datës së testimit dhe marrin një miratim

RAPORT PËRMBLEDHËS I MONITORIMIT I PROVIMIT TË MATURËS SHTETËRORE

me shkrim që mund ta shfrytëzojnë për të hyrë në qendrat e testimit”; “Monitoruesit mund të autorizohen nga KSHM për të monitoruar procesin e testimit qoftë për raportime tek mediat, organizatat joqeveritare dhe për qëllime të rritjes së presionit ndaj procesit të administrimit për të rritur nivelin e disiplinës”. Në këtë rast, Këshilli Rinor Kosovar ka parashtruar kërkesën për monitorim dhe është autorizuar nga KSHM për monitorim të Provimit të Maturës Shtetërore. KYC ka pasur të determinuar formularët e raportimit të monitoruesit të Provimit të Maturës Shtetërore dhe zbërthimi i këtyre formularëve në formë përbledhëse do të paraqitet më poshtë, përderisa përveç kësaj KYC ka zhvilluar dhe fazë të tjera monitorimi si pyetësorët online për të marrë dhe këndvështrimin e kandidatëve/eve **a)** për Fazën përgatitore të Provimit të maturës Shtetërore **b)** për Mbarëvajtjen e procesit të Procimit të Maturës Shetërore, si dhe forma të shpejta raportimi të parregullsive të mëdha gjatë procesit të provimit.

Në këtë rast, rëndësia e monitorimit shtrihet vlerëshmërisht në rëndësinë e mbarëvajtjes së procesit, për të lehtësuar kështu identifikimin e problemeve të shfaqura gjatë testimit, sfidave dhe parregullsive që ulin cilësinë e testimit, dhe për të krijuar rekomandime që do të kishin plotësuar dhe përmirësuar procesin e Provimit të Maturës Shtetërore në vitet e ardhshme.

2.1 Metodologja

Monitorimi i Provimit të Maturës Shtetërore është organizuar plotësisht nga Këshilli Rinor Kosovar me autorizim nga DVSM dhe miratim të KSHM.

Këshilli Rinor Kosovar ka angazhuar dyzet (40) monitorues/e në terren të cilët/at janë shpérndarë në dyzet (40) qendra të testimit në gjithsej njëzet e pesë (25) komuna.

Paraprakisht, monitoruesit/et janë pajisur me bexhët e akredituar nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe formularët e monitorimit të paracaktuara nga po i njëjti institucion më saktësisht nga DVSM dhe KSHM. Pjetjet e formularit kanë qenë të përcaktuara nga DVSM përderisa, përveç formularit të monitoruesit/es Këshilli Rinor Kosovar ka lansuar dhe një formular për raportim të shpejtë të pa-rregullësive në kohë reale për të mbledhur informatë specifike për shkelje të rregullave në secilën qendër të testimit ku gjithësej janë raportuar 31 raste të shkeljeve.

Monitoruesit/et e Provimit të Maturës Shtetërore, para daljes në terren i janë nënshtuar trajnimit për monitorim, ku ndër të tjera i janë bërë të njoitura rregullat që duhet të ndiqen të përcaktuara sipas Udhëzuesit për Maturën Shtetërore. Monitoruesit/et janë paraqitur në qendrat e testimit para nisjes së testimit (9:00) dhe janë larguar nga qendra e testimit në kohën e përfundimit të testit (12:30). Monitoruesit/et kanë raportuar parregullësitë dhe problemet e paraqitura në formularin për monitorim dhe atë për raportim të shpejtë pa e penguar procesin e testimit, pa diskutuar apo intervenuar.

RAPORT PËRMBLEDHËS I MONITORIMIT I PROVIMIT TË MATURËS SHTETËRORE

Formulari i monitorimit ka përmbajtur 16 pyetje – të hapura dhe gjysmë të hapura të dizajnuara në bazë matjen e respektimit të rregullave të procesit të maturës përcaktuar sipas Ligjit për Provimin e Maturës Shtetërore, dhe akteve të tjera nën-ligjore.

Informata e marrë nga terreni, është trajtuar me vlefshmëri të brendshme të besueshmërisë së të dhënave dhe analizuar me përpikmëri për ta publikuar atë në një raport përmbledhës të dhënave dhe statistikave shpjeguese. Rrjedhimisht, informata është analizuar me teknikën e analizës përmbajtësore.

Përderisa, ekipi i Këshillit Rinor Kosovar me eksperiencë hulumtuese ka përpiluar dhe pyetësorin për këndvështrimin e kandidatit/es të Provimit të Maturës Shtetërore, i cili ka përmbajtur 15 pyetje të hapura dhe gjysmë të hapura. Pyetësori është bazuar në dy komponenta qenësore ajo e **a) bazës që rrjedh** nga Ligji për Provimin e Maturës Shtetërore, Udhëzimi Administrativ Nr.04/2016 për Detyrat dhe Përgjegjësitë e Komisionit në Qendra të Testimit (në vazhdim “**UA për Detyrat dhe Përgjegjësit e Komisionit**”), Udhëzimi Administrativ Nr. 05/2016 për Detyrat dhe Përgjegjësitë e Administruesit dhe Mbikëqyrsit gjatë Procesit të Administrimit të Provimit të Maturës Shtetërore (në vazhdim “**UA për Detyrat dhe Përgjegjësitë e Administruesit dhe Mbikëqyrsit**”), Udhëzues për Maturën Shtetërore; Udhëzime, Rregulla për kandidatët/et dhe ajo e **b) bazës që rrjedh** nga mbarëvajtja e procesit në kushte të pandemisë dhe rregullave të përcaktura nga **IKPSHM** përcaktuar në Udhëzuesin për Maturën Shtetërore 2020 dhe Udhëzime, Rregulla për kandidatët/et.

Pyetësori për këndvështrimin e kandidatit/es është lansuar online në kanalet e Këshillit Rinor Kosovar, në pamundësi të intervistimit të kandidatëve/eve fizikisht për shkak të rrezikut të kanosur nga pandemia Covid-19. Pyetësorit i janë përgjigjur 606 respondentë. Përcaktimi i mostrës nuk është i qëllimshëm për shkak të lansimit online dhe mundësisë së përgjigjes nga secili/a kandidat/e i/e Provimit Shtetëror të Maturës. Tabela më poshtë paraqet demografishët komunat prej nga janë pranuar të dhënat në formularin për këndvështrimin e kandidatit/es.

RAPORT PËRMBLEDHËS I MONITORIMIT I PROVIMIT TË MATURËS SHTETËRORE




Figura 1. Komuna i/e kandidatit/es që i është nënshtruar Provimit të Maturës Shtetërore

Përveç, monitorimit në terren gjatë procesit dhe pas përfundimit të Provimit të Maturës Shtetërore, Këshilli Rinor Kosovar paraprakisht ka lansuar dhe pyetësorin për Fazën parapërgatitore të Provimit të Maturës Shtetërore – më saktësisht për të matur nivelin e gatishmërisë dhe përgatitjes së nxënësve karshi Provimit të Maturës Shtetërore. Pyetësori ka përbajtj 26 pyetje të hapura dhe të myllura dhe nuk ka pasur mostër të paracaktuar. Ky pyetësor është lansuar në kanalet sociale të Këshillit Rinor Kosovar dhe është plotësuar nga **2,395 respondentë**.

Në vazhdim do të trajtohen të dhënat e nxerra nga monitorimi në terren dhe ato të hulumtimit online të ndara në kapituj të ndryshëm.

03

Monitorimi në terren

3.1 Mbarëvajtja e procesit të provimit të maturës shtetërore - Të dhënat dhe statistikat e dala nga monitorimi në terren

Komunat dhe qendrat e monitorura:

Komuna	Shkolla	Nr. i Qendrës së testimit	Nr. i nxënësve
Prishtinë	SHMU "Xhemajl Mustafa"	21	181
Prishtinë	Gjimnazi "Xhevdet Doda"	14	202
Prishtinë	SHMM "Dr. Ali Sokoli"	8	204
Prishtinë	SHMT "28 Nentori"	17	194
Prishtinë	Kolegji "Don Bosko"	19	178
Prishtinë	SHMU "Dardania"	15	202
Prishtinë	SHMEJ "Hoxhe Kadri Prishtina"	20	168
Prishtinë	SHMU "Naim Frasheri"	26	170
Prishtinë	Gjimnazi "Sami Frasheri"	6	188
Prishtinë	Elena Gjika	7	188
Gjilan	GJ.N. "Xhavit Ahmeti"	1	197
Gjilan	GJ.SH. "Zemel Hajdini"	3	203
Gjakovë	SHMU "Zekeria Rexha" (objekti I ri)	6	180
Gjakovë	SHML Mjeksis "Hysni Zajmi"	2	180
Ferizaj	Shkolla "K. Arberit"	1	232
Ferizaj	Shkolla "Qendra e Kompetences"	5	139
Prizren	SHMU "Musafa Bakiu"	2	204

RAPORT PËRMBLEDHËS I MONITORIMIT I PROVIMIT TË MATURËS SHTETËRORE

Prizren	Gjimnazi "Gjon Buzuku"	1	204
Mitrovicë	Gjimnazi "Frang Bardhi"	1	204
Mitrovicë	Shkolla "Dr. Xheladin Deda"	4	204
Pejë	SHFMU "Asdreni"	2	180
Pejë	Gjimnazi "Bedri Pejani"	1	199
Fushë Kosovë	SHMEJ "H. Kadri Prishtina"	3	186
Klinë	Shkolla "Motrat e Qiriazi"	1	118
Deçan	Shkolla "V. Frasherri"	1	129
Vushtrri	Gjimnazi "Eqrem Qabej"	1	197
Obiliq	Gjim. 17 Shkurti	2	130
Podujevë	Gjimnazi " A. Xhuvani"	1	191
Istog	Shkolla "Haxhi Zeka"	1	161
Skenderaj	Gjim. Hamez Jashari	2	178
Drenas	Gjim. "Gjergj K. Skenderbeu"	1	108
Lipjan	Shkolla "Gjimnazi Ulpiana"	1	222
Shtime	Shkolla "Naim Frasherri"	1	143
Rahovec	Shkolla "Xhelal Hajda-Toni"	1	144
Dragash	SHM "Ruzhdi Berisha"	1	176
Kaçanik	Gjimnazi "Skenderbeu", Shkenca Natyrore.	1	110
Suharekë	SHMP "Skender Luarasi"	3	232

RAPORT PËRMBLEDHËS I MONITORIMIT I PROVIMIT TË MATURËS SHTETËRORE

Malishevë	Gjimnazi "Hamdi Berisha"	3	204
Kamenicë	Shkolla: "Ismail Qemalili"	1	62
Viti	ML Profesionale "Januz Zejnallahu"	3	193

3.1.1 Koha e nisjes nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës

Sipas nisi 3, paragrafi 1 pika 1 e UA për Deyrat dhe Përgjegjësitë e Komisionit, "Kryetari i Komisionit është përgjegjës për administrimin e përgjithshëm të provimit të maturës shtetërore dhe ka për detyrë: të paraqitet në kohë në lokalet e MASHT/DVSM dhe t'i pranojë materialet përkatëse;" **Mirëpo në asnjerën nga aktet nënligjore dhe në Udhëzuesin për Maturën Shtetërore nuk përcaktohet shprehimisht koha e nisjes nga MASH.** Informata e tillë ju ofrohet Komisionit në takimet informative ku përcaktohen detyrat dhe përgjegjësit në të cilat takime monitoruesit/et e Këshillit Rinor Kosovar nuk kanë marrë pjesë më saktësisht sipas Udhëzuesit për Maturën Shtetërore "DVSM jep udhëzime të qarta për Kryetarët e Komisioneve të Qendrave të Testimit përmarrjen e materialit të testimit duke specifikuar qartë kohën e paraqitjes dhe vendin e paraqitjes. Kryetarët informohen një ditë më parë për të gjitha detajet e pranimit dhe dorëzimit të materialit të testimit ndërsa për procedure dhe rregullat e tjera do të informohen në seancat informative dhe trajnimet e ngajshme paraprake". Poashtu, sipas Udhëzuesit për Maturën Shtetërore – 2020, pika VII- Monitoruesi në këtë rast Këshilli Rinor Kosovar duhet të jetë në kohë sipas orarit të caktuar në qendrën të cilën e monitoron dhe ka për detyrë të përcjell procesin e testimit nga koha e nisjes nga DVSM deri te përfundimi i testimit dhe kthimi në DVSM në formë të raportit të shkruar. **Megjithatë, DVSM i ka këruar monitoruesëve/eve të Këshillit Rinor Kosovar të mos paraqiten në permisat e DVSM por të paraqiten në qendrat e testimit një orë (60 minuta) para nisjes së testmit, me arsyetimin e mos grumbullimit të shumë personave në një hapësirë për shkak të masave të IKSHPK-së përmbrojtje nga Covid-19 si dhe në pamundësi të krijimit të hapësirës së transportit të monitoruesit/es në qendrat e caktura. Rrjedhimisht, Këshilli Rinor Kosovar ka organizuar në mënyrë vetanake arritjen e monitoruesëve në qendra të testimit, dhe si pasojë monitoruesi/ja e ka pasur të pamundër të masë kohën e nisjes së Komisionit, Administruesit/es dhe Mbikëqyrësit/es nga MASH dhe vetëm ka monitorur kohën e paraqitjes së tyre në qendër.** Gjithashtu, pyetja e kohës së nisjes dosido i është bashkëngjitur formularit të Monitorimit të Procesit i përpiluar dhe paracaktuar nga vet KSHM-ja dhe DVSM-ja.

3.1.2 Koha e arritjes në qendrën e testimit

Siç është para-shpjeguar, aktet nënligjore në fuqi dhe Udhëzuesi për Maturën Shtetërore 2020 ka përcaktuar si detyrë dhe përgjegjësi që monitoruesit/et të paraqiten në qendrat e testimit një orë (60 minuta) para fillimit të procesit. Rrjedhimisht, monitoruesit/et në terren

kanë deklaruar se kanë qenë në kohë në qendrat e testimit dhe nuk është reportuar ndonjë rast shkeljeje në këtë aspekt. Në **59%** të rasteve, monitoruesit/et janë paraqitur në qendrat e testimit **brenda periudhës kohore 8:00 deri në 9:00, kjo mbi besimin e ndjekjës së përcaktimit të orës për hyrje të kandidatëve/eve brenda klasave.** Përderisa në **41% të rasteve**, monitoruesit/et janë paraqitur në qendra të testimit në ora **9:00** ashtu siç u është kërkuar.




Figura 2. Koha e arritjes në qendër të testimit

3.1.3 Qendra ishte e përgatitur ?

Sipas, Udhëzuesit për Maturën Shtetërore 2020 për realizim të testit në kushte të pandemisë dhe sipas rregullave të IKSHP-së qendrat e testimit duhet të kenë të rregulluar infrastrukturën për mbajtjen e testimit, rrjedhimisht, “*duhet të dezinfektohen (secila klasë mësimi), të sigurohen dezinfektues në secilën sallë dhe në hyrje të objektit*”. Përderisa Shkolla e Mesme e Lartë (në vazhdim “**SHML**”) ka për detyrë dhe përgjegjësi të a) përgatit hapësirën për mbajtjen e provimit të matures shtetërore sipas udhëzimeve nga KSHM/DVSM; b)në hyrje të shkollës në vendin e shpalljeve ose në një vend të dukshëm shënon listen finale të nxënësve; c) në porten e çdo klase shkruhet lista e nxënësve që do të testohen; d)siguroj kushtet e organizimit të testit të maturës, më saktësisht “ *duhet të merrë parasysh numrin e klasave që nevojiten për sigurimin e kushteve të njëjtë në secilën klasë duke përfshirë dhe dritën dhe ajrosjen e klasës.*

Ndër të tjera, “*Secila sallë duhet të ketë më së shumti 12 banka dhe 12 karrika plus dy banka dhe 2 karrika për adminisruesin dhe mbikqyrësin e testimit. Distanca në mes të bankave duhet të jetë e njëjtë për të gjitha klasat si dhe distancë mes nxënësve duhet të jetë optimale. Lidhur me situatën COVID, bankat duhet të rradhitën ashtu që të ketë së paku 2 metra largësi mes nxënësve dhe pamundësohet kopjimi.*” Poashtu, Shkolla sigurohet që në ditën e testimit

mund të mbyllt dera e shkollës sipas udhëzimeve të Kryetarit të Komisionit të Qendrës së Testimit.

Duke i pasur të qarta të gjitha kriteret e vendosura më lartë, **95%** e monitoruesëve/eve kanë raportuar se qendra ishte e përgatitur, përderisa **5%** e tyre kanë raportuar se qendra nuk ishte e përgatitur sipas kritereve të paraqitura duke qenë se në këto raste sipas deklarimeve nxënësit/et nuk kanë qenë mirë të sistemuar në klasa. Në paraqitjen e komenteve të përgjithëshme të mbarëvajtjes së provimit të maturës shtetërore monitoruesit/et kanë elaboruar raste specifike si:

- Dy (2) raste të mos-mbajtjës së distancës prej dy (2) metrash, në oborrin e shkollës gjatë pritjes për të hyrë në testim;
- Një Rast të hyrjes në testim të kandidatit/es tridhjetë (30) minuta pas mbylljes së derës së shkollës;
- Në një qendër, dera e një klase të testimit ka qëndruar e mbyllur në fillim të testimit për tridhjetë (30) minuta.

Ndërkaq, nga formularët për raportim të shpejtë nga 31 rastet e raportimit, **12.9%** paraqesin **ambientin** si problem të mbarëvajtjes së testit të maturës dhe **9.7% kanë raportuar distancën sociale si problem**.




Figura 3 – Qendra ishte e përgatitur ?

3.1.4 A kanë ardhur me kohë Administruesit ?

Sipas Neni 3, paragrafi 1.3 të UA për Detyrat dhe Përgjegjësitë e Komisionit, “*Komisioni duhet të paraqitet në qendrën e testimit ku është i caktuar një orë (60 minuta) para fillimit të testit*”; përdersia sipas Udhëzuesit për Maturën Shtetërore 2020, pika 4.2 – Anëtarët e Komisionit duhet të paraqiten në qendrën e testimit 90 minuta para fillimit të testimit. Përderisa, sipas

RAPORT PËRMBLEDHËS I MONITORIMIT I PROVIMIT TË MATURËS SHTETËRORE

nenit 3, paragrafi 1, pika 3, Administruesi/ja duhet të paraqitet në qendrën e testimit ku është i/e caktuar një orë (60 minuta) para fillimit të testimit dhe neni 4, paragrafi 1, pika 3 – “*Mbikëqyrësi ka për detyrë dhe përgjegjësi të paraqitet në qendrën e testimit ku është i caktuar një orë (60) minuta para fillimit të testimit*”. I njëjtë kusht është përcaktuar dhe në Udhëzuesin për Maturën Shtetëore 2020, **pika V, Administruesi i testimit ka këto përgjegjësi dhe detyra: të paraqitet në qendrën e testimit (së paku) një orë para fillimit të testimit dhe VI – Detyrat dhe përgjegjësitë e mbikëqyrësит janë: të paraqitet në qendrën e testimit ku është i caktuar një orë (60 minuta) para fillimit të testimit.**

Në këtë rast sipas monitorimit në terren 88% e monitoruesëve/eve kanë deklaruar që administruesit kanë qenë në qendër të testimit me kohë pra një orë (60 minuta) para fillimit të testit, përderisa, në **12% të rasteve administruesit** nuk kanë arritur me kohë në qendër të testimit. Rrjetimisht, pyetja varëtse se pse nuk kanë qenë administruesit në qendër të testimit në kohë nuk mund të përgjigjet sepse parimisht monitoruesit/et nuk kanë pasur të drejtë komunikimi dhe diskutimi. Në këtë rast, arsyja e mos-ardhjes nuk kohë nuk mund të dihet nga monitoruesit/et. Mirëpo raportimi i tyre tregon që:

- Në një qendër, administruesit/et dhe komisionerët nuk kanë ardhur në kohë që të gjithë, por ka pasur vonesa dhe ardhja ka qenë graduale, disa kanë arritur pas prezantimeve fillestare;
- Në një qendër, dy deri në tre administrues/e të angazhuar nuk janë paraqitur fare në qendrën e testimit gjë që ka shkaktuar vonesë së fillimit të testimit;
- Në një qendër, një administrues/e nuk ka ardhur fare në qendër të testimit por është zëvendësuar me një administrues/e rezervë;
- Në një qendër, tre administrues/e kanë ardhur me vonesë në qendër të testimit;
- Në një qendër, shtatë (7) administrues/e kanë ardhur me vonesë në qendër të testimit;




Figura 4 – A kanë ardhur me kohë administruesit ?

3.1.5 Koha e futjes së nxënësve në qendër?

Sipas Udhëzuesit për Maturën Shtetërore 2020 dhe Udhëzuesit dhe Rregullave për Kandidatët/et orari i përcaktuar për ditën e testimit është si vijon: Nga ora 8:30 deri në ora 9:00 bëhet arritja e kandidatëve/eve në oborret e qendrave të testimit (shkollës) dhe **nga ora 9:00 deri në ora 9:30 bëhet hyrja e kandidatëve/eve në qendra të testimit dhe sistemimi i tyre në klasat e përcaktuara**. Ndërsa tjetra, sipas UA për Detyrat dhe Përgjegjësitë e Komisionit, UA për Detyrat dhe Përgjegjësit e Administruesit dhe Mbikëqyrësit - si detyra dhe përgjegjësi në vartësi janë dhe: **Kontrollimi i hapësirës ku mbahet testimi paraprakisht; Mirëpritja e kandidatëve/eve dhe sistemimi i tyre; Përkujdesja që të gjithë kandidatët/et janë të pranishëm/e pesëmbëdhjetë (15) minuta para fillimit të testimit; Pranimi dhe Kontrollimi i Materialeve; Koordinimi i mbarëvajtjes së administrimit të testit.**

Ndërsa tjetra, orari i përcaktuar lehtëson mbarëvajtjen e procesit të Provimit të Maturës Shtetërore, meqenëse minutazhi i testimit është poashtu i përcaktuar, dhe specifisht marrë parasysh rrethanat në të cilat është organizuar provimi i maturës shtetërore, ku mbi të gjitha ka qenë shumë e nevojshme respektimi i masave të rekomanduara nga IKSHPK për ruajtje të distancës, dezinfektim të duarëve në hyrje, dhe sigurimi që secili/a kandidat/e ka maskë mbrojtëse.

Rrjedhimisht, sipas raportimeve të monitorimit në terren, në **24% të rasteve kandidatët/et** kanë filluar të sistemojnë në klasat e testimit para orës së përcaktuar do të thotë në mes intervalit **kohor 8:30 – 9:00** ose më saktësisht në kohën kur ata/ato kanë pasur të caktuar të arrijnë në oborr të qendrave të testimit. Përderisa përvèç rasteve të sistemimit në klasa më herët, në **17% të rasteve kandidatët/et** kanë filluar të hynë brenda qendrës së testimit brenda intervalit kohor **9:30 – 10:00**, ose më saktësisht **30 minuta më vonë se përcaktimi i orës së**

hyrjes në klasa. Ndërkaq, në **59% të rasteve**, kandidatët/et kanë filluar të hynë në klasa në kohën e përcaktuar, pra brenda intervalit kohor **9:00-9:30**.




Figura 5. Sistemimi i kandidatëve/eve në klasat e testimit

3.1.6 A ka rekomanduar para hyrjes drejtori me kryetarin e komisionit largimin e telefonave dhe mjeteve tjera elekronike?

Udhëzuesi i Maturës Shtetërore 2020 udhëzon që: "Drejtori i shkollës me kryetarin e komisionit të dalin para hymjes së shkollës 15 minuta para se nxënësit të futen mbrenda dhe t'ju rekomandojnë nxënësve që askush të mos futet mbrenda me telefona apo mjete tjera elektronike që janë të ndaluara sipas ligjit, ndryshe të gjitha ata që futen mbrenda me mjetet e lartcekura do të largohen dhe do e humbin të drejtën e rezultatit."

Në rastet e monitoruara në terren nga Këshilli Rinor Kosovar, **88%** e monitoruesëve/eve kanë deklaruar që në qendrat e testimit ku ata/ato kanë monitoruar, Drejtori dhe Kryetari i Komisionit **kanë rekomanduar largimin e telefonave** dhe mjeteve të tjera elektronika. Përderisa, në **12% të rasteve** treguar nga monitorimi në terren **ky rekomandim nuk ju është dhënë** kandidatëve/eve në hyrje. Ndërkaq, pyetja varëtse e përcaktuar në pyetësorin e monitorimit të në terren - se pse nuk kanë rekomanduar Drejtori dhe Kryetari i Komisionit largimin e telefonave në hyrje nuk mund të përgjigjet sepse parimisht monitoruesit/et nuk kanë pasur të drejtë komunikimi dhe diskutimi. Në këtë rast, arsyja e mos rekomandimit nuk mund të dihet nga monitoruesit/et. Mirëpo raportimi i tyre në disa raste tregon që:

- Në një qendër, nxënësve ju janë larguar telefonat pasi që kanë hyrë në klasë;
- Në një qendër, Kryetarja e Komisionit nuk ka qenë prezente tek hyrja pasi që është vonuar;
- Në një qendër, rekomandimi i është dhënë nxënësve nga administruesit/et pasi që kanë hyrë në klasat e testimit.




Figura 6. Drejtori i shkollës dhe Kryetari i Komisionit kanë rekomanduar largimin e telefonit

3.1.7 Koha e fillimit të testimit ?

Orari i caktuar për ditën e testimit, i cili paraqitet dhe në Udhëzuesin për Maturën Shtetërore-2020 përcakton që nga **ora 9:30 deri në orën 10:00 të ofrohen udhëzime dhe sqarime** për kandidatët/et për testin dhe fletë-përgjigjet nga ana e administratorit/es të testimit. Përderisa, **në ora 10:00 përcakton fillimin e testimit.** Ndërkaq, sipas Udhëzuesit për Maturën Shtetërore “Administruesit nuk duhet të lejojnë futjen e nxënësve në sallë pasi të fillojnë dhëni e udhëzimeve e po ashtu duhet të sigurohen që fillimi i testimit bëhet në kohën e caktuar (dhe pas sinjalit të dhënë nga Kryetari i Komisionit Qendor) dhe duhet të sigurohen që testimi përfundon në kohën e caktuar (150 minuta pas fillimit).”

Mbi këtë rregullim nga dyzet e një (41) qendra sa janë monitoruar, në **88%** të tyre testimi ka nisur brenda intervalit kohor **9:45(pak raste) – 10:00**. Ndërkaq, në **12%** testimi ka filluar në interval kohor prej **10:05 -10:20**.




Figura 7. Fillimi i testimit

3.1.8 A kishte shkelje gjatë testimit ?

Për të realizuar qëllimin e mirëmbajtjes dhe mbarëvajtjes së procesit të Provimit të Maturës Shtetërore, sipas të gjitha kritereve dhe udhëzimeve të kredituara nga organet institucionale – Ministria e Arsimit dhe Shkencës ka nxjerrur një mori udhëzueshish e udhëzimesh që rrjedhin si akte nën-ligjore me bazë Ligjin për Provimin e Maturës Shtetërore. Ku, ndër të tjera përcaktohen shprehimisht të gjitha detajet për mbarëvajtje të provimit, të drejtat dhe përgjegjësitet e secilës palë dhe institucion që përçon dhe vet angazhimin e të gjitha palëve për të u përcjellur të gjitha rregullat e sjelljes dhe realizimit të procesit të testimit. Ndjekur këtë esencë për të evitar çdo pa-rregullësi dhe shkelje, madje Ligji për Provimin e Maturës Shtetërore, neni 29 e tij parashev dhe dispozitat ndëshkimore për secilën palë në rast se shkeljet vërtetohen dhe ndodhin. Prandaj, monitoruesit/et e Këshillit Rinor Kosovar me vëmendje kanë përcjellur dhe identifikuar shkeljet me c'rast në **52% të rasteve** është dekluaruar që nuk ka pasur shkelje përdersia në **48%** ose më saktësisht në 20 qendra të testimit nga 40 sa janë monitoruar ka pasur shkelje gjatë procesit të Provimit të Maturës Shtetërore.




Figura 8. Shkeljet gjatë procesit.

Si pyetje vijuese e prezantimit vendoset dhe deklarimi i monitoruesëve/eve që kanë evidentuar shkelje gjatë procesit të cilët/at përmes përgjigjeve të hapura por dhe formës pë raportim të shpejt kanë elaboruar llojet e shkeljeve të hasura në qendër. Secili/a nga 48% sa janë përgjigjur që ka pasur shkelje ka listuar një deri në disa shkelje brenda qendrës së tyre të testimit të cilat në këtë raport përshkrues paraqiten të grumbulluara në llojet më të shpeshta të shkeljeve dhe më të zakonta.

Rrjedhimisht, janë listuar gjithsej 57 shkelje të ndryshme të cilat në përqindje klasifikohen me shpjegim si më poshtë:

Në 5.26 % është deklaruar që në qendër të testimit ka mbizotëruar zhurmë në klasa dhe korridore;

Në 19.30% të rasteve ka pasur bashkëpunim mes nxënësve, kopjim mes kandidatëve/eve dhe në raste specifike dhe lejim bashkëpunimi nga vet administruesit/et e testit;

Në 22.81% të rasteve të monitorimit ka ekzistuar keq-administrimi – me c'rast janë evidentuar shkelje si: ardhje me vonesë, ndihmë në plotësim të testit ndaj kandidatëve/eve, lejim bashkëpunimi, dalje nga klasa);

Në 7.02% të qendrave nuk janë respektuar masat e përcaktuara nga IKSHPK kundër Covid-19 dhe është deklaruar për mos mbajtje të distancës, kaos në hyrje në qendër, mos -mbajtja e maskës nga kandidatët/et si dhe nga administruesit/et dhe mbikëqyrësit/et.

Në 10.53% të qendrave janë vërejtur probleme teknike si me lista të emrave të kandidatëve/eve, me përzgjedhjen e lëndëve zgjedhore (do të thotë nuk kanë pasur në test lëndën që kanë zgjedhur), me dokumente të kandidatëve si letërnjoftimin apo fletëparaqitjen

RAPORT PËRMBLEDHËS I MONITORIMIT I PROVIMIT TË MATURËS SHTETËRORE

si dhe probleme teknike me testet – (si shembull: testi ka qenë A ndërkaq fletëpërgjigja B, mungesë të testeve rezervë etj);

Në 1.75% të rasteve janë ndëgjuar ankesa për mos-përputhje të pyetjeve të testimit me planprogramet mësimore;

Në 3.51% të rasteve dhe pse e ndaluar me udhëzues, kandidatët/et janë lejuar të dalin nga qendra në rast të përfundimit të testit para kohës së përfundimit;

Në 17.54% të rasteve është deklaruar që kandidatët/et kanë përdorur telefonët edhe pse të udhëzuar të mos i bartin dhe vënë këto pajisje në një kënd të veçantë;

Në 8.77% të rasteve është deklaruar për keq-mbikëqyrje, më saktësisht për mos ndjekje të rregullave dhe mos marrje të masave të mbikëqyrësve në rast të shkeljeve apo keq-administrimit.




Figura 8.1 Shkeljet gjatë testimit

3.1.9 A kishte largim të nxënësve apo administruesve?

Sipas nenit 3 paragrafit 2 pika 9 të UA për Detyrat dhe Përgjegjësitet e Komisionit -dy anëtarët e tjerë të Komisionit janë përgjegjës për mbarëvajtjen e procesit të provimit të maturës shtetërore dhe kanë për detyrë **të marrin vendim për largimin e kandidatëve që nuk i përfillin rregullat e caktuara dhe ta zbatojnë atë përmes personave zyrtarë**. Gjithashtu, përmes UA për Detyrat dhe Përgjegjësitet e Administruesit, neni 3, parografi 1.23 i jepë të drejtë administruesit/es "të largojë nga testi kandidatin në rast të mos-respektimit të rregullave dhe për këtë të njoftojë mbikëqyrësin". Ndër të tjera, neni 4 i po të njëjtit akt nënligjor, parografi 8 përcakton që: "*Mbikëqyrësi ka përgjegjësi të moj lejoj administruesit tu*

RAPORT PËRMBLEDHËS I MONITORIMIT I PROVIMIT TË MATURËS SHTETËRORE

ndihmojnë kandidatëve dhe të reagojnë në situata të tillë. Në rast të mos-përfilljes së rregullave nga administruesit, në konsultim me kryetarin e Komisionit të qendrës së testimit e largon atë nga detyra” Përveç UA përmes Udhëzuesit për Maturën Shtetërore është përcaktuar poashtu që “Kryetari i Komisionit u bënë me dije administruesve se raportet e mbikëqyrësit mund të raportojnë pa-rregullësitë dhe përveç ndalesës së pagesave do të ketë dhe masa të tjera nga MASH si p.sh publikimi i emrave për ata që kanë administruar keq procesin e testimt..”. Mirëpo duhet theksuar që Ligji për Provimin e Maturës Shtetërore – shprehimisht ka përcaktuar dispozitat ndëshkimore në rast të mos-respektimit të rregullave nga palët. Më saktësisht përcaktohet:

- “1. Anëtarët e Komisionit në qendrat e testimit, administruesi, mbikëqyrësi dhe vëzhguesi i provimit të maturës shtetërore që shkel rregullat e administrimit të testit, ndëshkohet për kundërvajtje në shumë prej treqind euro (300) € deri në pesëqind euro (500) €.*
- 3. Kandidatët të cilët gjatë provimit të maturës shtetërore shkelin rregullat e mirësjelljes, të përcaktuara me udhëzues përkatës për provim, ju anulohet testi i maturës dhe të njëjtët i nënshtrohen provimit në afatet vijuese.”*

Megjithatë, monitorimi në terren na pasqyron që në **71.4%** të rasteve të monitorimit nuk pasur largim të nxënësve apo administruesëve/eve nga qendra e testimt përderisa në **28.6%** të rasteve të tjera ka pasur largime vetëm të nxënësve dhe në të gjitha rastet deklarohet në përgjigjet e hapura të monitorusëve/eve që arsyeva e largimit ka qenë përdorimi apo tentimi për përdorim të telefonave.




Figura 9. Largimi nga testimi i kandidatëve/eve.

3.1.10 A pati hyrje të nxënësve pas fillimit të testit ?

Sipas udhëzimeve praktike të specifikuara në Udhëzuesin për Maturën Shtetërore, Kryetari/ja i/e Komisionit duhet “të sigurohet që dyert e qendrës së testimit janë mbyllur sipas orarit të paraparë(pra në momentin që kandidatët/et sistemohen) dhe pas kësaj kohe nuk do të lejohet hyrja e askujt në qendër të testimit” dhe udhëzon palët e tjera të ndërmarrin masat e duhura për të respektuar këtë përcaktim.

Në këtë rast, monitorimi në qendra të testimit ka pasqyruar që në **88%** të rasteve nuk ka pasur hyrje ose lejim për të hyrë në testim pas fillimit të orarit të përcaktuar sipas Udhëzuesit, përderisa në **12%** të rasteve kandidatët/et që janë paraqitur me vonesë në qendrat e testimit janë lejuar të hyjnë në testim dhe pas orarit të përcaktuar dhe pas mbylljes së derës që gëndrës.




Figura 10. Hyrja e kandidatëve/eve në testim me vonesë

3.1.11 Koha e mbarimit të testimit ?

Sipas Udhëzuesit për Provimin e Maturës Shtetërore, orari për ditën e testimit që është dhënë në tabelë, ka bërë të qartë që testimi duhet të mbaroj në ora 12:30. Do të thotë pas dy orësh e tridhjetë minuta (2 e 30) nga fillimi i tij në ora 10:00. Në këtë rast monitoruesit/et e Këshillit Rinor Kosovar kanë vëzhguar mbarimin e testimit në qendra duke marrë parasysh dhe peripecitë dhe vonesat që kanë ndodhur në disa prej qendrave. Kësisoj është deklaruar që në shumicën e qendrave, apo më saktësisht në **57%** të tyre testimi ka përfunduar në kohën e paraparë pra në **12:30**. Mirëpo, në pjesën tjeter të qendrave ka pasur lëvizje në këtë aspekt duke nisur që në **12%** të qendrave testimi ka përfunduar para kohës së paraparë ose më saktësisht në mes të orës **12:10 – 12:30**, kjo siç është deklaruar sepse kandidatët/et i kanë përfunduar testet para kohës së përcaktuar. Përderisa, në **26%** të rasteve të tjera për shkak të vonesave fillestare testi nuk ka përfunduar me kohë por ka përfunduar në mes të orës **12:30 -12:45**, ndërkaq, në **5%** të rasteve ka pasur vonesë të jashtëzakonshme duke ditur që

testimi ka përfunduar mes orës **13:00 – 13:30**, me të fundit krahasim i bie një (1) orë më vonë se që është përcaktuar.




Figura 11. Koha e mbarimit të testimit

3.1.12 Koha e kthimit në MASH

Në asnjëren nga aktet nënligjore dhe në Udhëzuesin për Maturën Shtetërore nuk përcaktohet shprehimisht koha e nisjes nga MASH. Informata e tillë ju ofrohet Komisionit në takimet informative ku përcaktohen detyrat dhe përgjegjësit në të cilat takime monitoruesit/et e Këshillit Rinor Kosovar nuk kanë marrë pjesë më saktësisht sipas Udhëzuesit për Maturën Shtetërore “*DVSM jep udhëzime të qarta për Kryetarët e Komisioneve të Qendrave të Testimit përmarrjen e materialit të testimit duke specifikuar qartë kohën e paraqitjes dhe vendin e paraqitjes. Kryetarët informohen një ditë më parë për të gjitha detajet e pranimit dhe dorëzimit të materialit të testimit ndërsa për procedure dhe rregullat e tjera do të informohen në seancat informative dhe trajnimet e ngjajshme paraprake*”. Poashtu, sipas Udhëzuesit për Maturën Shtetërore – 2020, pika VII- Monitoruesi në këtë rast Këshilli Rinor Kosovar duhet të jetë në kohë sipas orarit të caktuar në qendrën të cilën e monitorin dhe ka për detyrë të përcjell procesin e testimit nga koha e nisjes nga DVSM deri te përfundimi i testimit dhe kthimi në DVSM në formë të raportit të shkruar. **Megjithatë, DVSM i ka këruar monitoruesëve/eve të Këshillit Rinor Kosovar të mos paraqiten në permisat e DVSM pas përfundimit të Provimit të Maturës Shtetërore, me arsyetimin e mos grumbullimit të shumë personave në një hapësirë për shkak të masave të IKSHPK-së për mbrojtje nga Covid-19.** Në këtë rast, Këshilli Rinor Kosovar ka pasur të pamundër të masë kohën e kthimit së Komisionit, Administruesit/es dhe Mbikëqyrësit/es në MASH dhe vetëm ka monitorur kohën e përfundimit dhe organizimin e materialeve dhe testeve pas përfundimit. Megjithatë, pyetja e kohës së kthimit në MASH dosido i është bashkëngjitur formularit të Monitorimit të Procesit i përpiluar dhe paracaktuar nga vet KSHM-ja dhe DVSM-ja.

04

Këndvështrimi i kandidatit/ës

4.1 Parapërgatitjet për provimin e maturës shtetërore

Përgjatë kapitullit të dytë të raportit përmbledhës të Provimit të Maturës Shtetërore do të shtjellohet këndvështrimi i kandidatit/es si qendër konkrete për Këshillin Rinor Kosovar. Ky kapitull është degëzuar në dy elemente specifike të Provimit të Maturës Shtetërore, sidomos duke marrë parasysh një organizim dhe mbajtje të provimit në kushte kaotike sistemore përgjithësisht për shkak të rrezikut dhe situatës së krijuar nga Covid-19. Kategoria e parë e trajtuar është **II.1 Parapërgatitjet për Provimin e Maturës Shtetërore** dhe **II.2 Mbarëvajtja e procesit** të Provimit të Maturës Shetërore.

Historiku i rrethanave të krijuara që kanë shtyrë këtë vit dhe monitorimin e parapërgatitjeve tregon që këtë vit, përmes Vendimit 01/07 të mbledhjes së shtatë të Qeverisë së Republikës së Kosovës, me qëllim të parandalimit të infekzionit Corona Virus COVID-19 është aprovuar kërkesa e Ministrisë së Shëndetësisë për ndërmarrjen e masave si: **“Ndërprerja e procesit edukativo-arsimor në institucionet arsimore publike dhe private në të gjitha nivelet më 27 mars 2020, me rekomandim që të lirohet njëri prind nga puna”**. Pas ndërprerjes së mësimit, me bazë këtë vendim, MASH-i ka filluar zbatimin e mësimit në distancë për klasat 1-9, përmes lansimit të platformës e-mësimi të shpërndarë në kanalet televizive publike si RTK 1 dhe RTK 4. Në këtë rast përmes Udhëzimeve për Drejtoritë Komunale të Arsimit për realizimin e mësimit online për shkollat e mesme të larta (në vazhdim: **“Udhëzime për DKA-të për mësim online”**) MASH-i u kërkon DKA-ve të fillojnë përgatitjet dhe inkurajimin e shkollave të zhvillojnë mësimin në distancë me nxënësit në mënyrë të decentralizuar në nivel shkolle dhe me mësimdhënësit në nivel klase. Ndërkaq, përmes **Vendimit nr.25/01** për procedurat e realizimit të vlerësimit të nxënësve gjatë mësimit në distancë në të gjitha nivelet e arsimit (në vazhdim: **“Vendim për Procedurat e Realizimit të Vlerësimit”**) në pikën 11 të tij saktësohet se: *vendimi për mbajtjen e Testit të Arritshmërisë (klasa 9) dhe Provimit të Maturës(klaza 12), merret në muajin maj nga MASH-i në konsultim me autoritetet dhe institucionet përkatëse*. Rrjedhimisht, Testi i Arritshmërisë pas disa analizimeve është anuluar me vendim, ndërkaq, fillimisht, përmes një **Komunikate** të lëshuar më 12 maj 2020 nga KSHM pas shqyrëtimit të shqetësimeve të palëve të ndryshme, konsultimeve dhe analizimit të bazës ligjore ka vendosur që: “Provimi i Maturës Shtetërore 2020 të mbahet në javën e parë të muajit korrik 2020” si dhe është vendosur që të mbahet brenda një ditë me vetëm 100 kërkesa (pyetje, detyra). Me një **njoftim** tjetër të datës 28 maj 2020, MASH përcakton datën 4 korrik 2020 për organizim të Provimit të Maturës Shetërore përderisa me Vendim të Ministrit Likaj të MASH, me numër 01-12, është vendosur Shtyrja e Afatit të Testit të Maturës Shtetërore, përcaktuar në paragrafin 1.2. **Testi i provimit të maturës shtetërore mbahet më 29.08.2020**. Si rrjedhojë e përcaktimit të datës së organizimit të Provimit të Maturës Shtetërore me **Njoftim** të datës 13 qershor 2020, Ministri Likaj ka marrë vendim që **“mësimi plotësues i ambientimit dhe përgatitjes së nxënsëve për Testin e Maturës për klasët e 12-ta të mbahet në formën online (mësim në distancë)”**.

RAPORT PËRMBLEDHËS I MONITORIMIT I PROVIMIT TË MATURËS SHTETËRORE

Këshilli Rinor Kosovar, duke e pasur të pamundur të monitoroj hollësishët mësimin plotësues online për nxënësit e klasëve të 12-ta si maturantë, prandaj para organizimit të Provimit të Maturës Shetërore ka lansuar një pyetësor online në kanalet e organizatës në rrjetet sociale. Ky pyetësor është ndarë në disa pjesë matjeje, fillimisht ka mbledhur të dhëna demografike si gjinia, komuna dhe mosha. Seksoni i dytë është përqëndruar në pjesën individuale të kandidatit/es në lidhje me atë se sa të përgatitur, stresuar dhe informuar janë ata. Seksioni i tretë është i fokusuar më shumë në parapërgatitjet për Provim të Maturës Shtetërore online. Seksioni i katërt mbledhë të dhëna të këndvështrimit të kandidatit/es për Mësimin Online gjatë periudhës së pandemisë Covid-19, dhe në seksionin e fundit maten deklaratat e vërteta dhe të pavërteta për çështjet e ndërlidhura nga tre seksionet paraprake. Të gjitha pyetjet e pyetësorit janë të llojit të mbyllur dhe është përgatitur nga vet Këshilli Rinor Kosovar. Pyetësorit i janë përgjigjur **2,395 respondentë**. Prej të cilëve 78.4 % kanë qenë vajza dhe 21.2% djem. Përderisa, mosha e respondentëve ka varijuar kryesisht në mes të 63.8% si 18 vjeç dhe 29.9% 17 vjeç. Pyetësorit i janë përgjigjur respondentë nga komuna të ndryshme të vendit sikurse janë paraqitur në tabelën më poshtë, dominuar më shumë nga shtatë (7) regionet më të mëdha të Kosovës, rënditur sipas lartësisë së respondentëve, **Prishtinë (323 ose 13%)**, **Pejë (277 ose 12%)**, **Prizren (224 ose 9%)**, **Ferizaj (165 ose 7%)**, **Gjakovë (139 ose 6%)**, **Gjilan (118 ose 5%)** dhe **Gjilan (118 ose 5%)**.




Figura 12. Numri i respondentëve/eve për komunë

Nga të gjithë respondentët/et e pyetësorit mbi informatën për fazën përgatitore të Provimit të Maturës Shtetërore, **90% e tyre do ti nënshtrohen Provimit të Maturës Shtetërore-2020, ndërkaq 10% prej tyre nuk do të i nënshtrohen** Provimit të Maturës Shtetërore të cilët rrjedhimisht nuk u është kërkuar dhe nuk u janë përgjigjur pyetjeve që do të elaborohen më poshtë në këtë raport përbledhës.

4.1.1 Sa ndjeheni të përgatitur për të ju nënshtuar Provimit të Maturës Shtetërore?

Sipas Nenit 12, paragrafi 1.3 të Ligjit për Maturën Shtetërore, Shkolla e Mesme e Lartë përgatit dhe ofron program mbështetës për provimin e maturës shtetërore. Për shkak të pamundësisë së ofrimit të këtij programi në ambientet shkollore me vendim të ministrit Likaj

mësimi plotësues i ambientimit dhe përgatitjes së nxënsëve për Testin e Maturës për klasët e 12-ta është mbajtur në formën online (**mësim në distancë**). Do të thotë nga data 13 qershor 2020 kur dhe është marrë vendimi për përgatitjet për Provim të Maturës Shtetërore online deri më 29 gusht 2020 në ditën e testimit, nxënësit/et e klasave të 12-ta si kandidatë/e të Provimit të Maturës Shtetërore – 2020 kanë pasur kohë të përgatiten online për një periudhë gati tre (3) mujore ose më saktësish shtatëdhjetë e shtatë (77) ditë.




Figura 13. Sa të përgatitur janë kandidatët/et për Provimin e Maturës Shtetërore

Në këtë rast, se sa të përgatitur janë kandidatët/et për të ju nënshtruar Provimit të Maturës Shtetërore, vetëm 3% e respondentëve i janë përgjigjur si plotësisht të përgatitur për të ju nënshtruar testimit, përdersia pjesa më e madhe thotë që nuk janë mjaftueshëm ose fare të përgatitur apo më saktësish 27% e respondentëve janë ndjerë si mesatërisht të përgatitur, 40% si deri diku të përgatitur dhe 20% kanë konsideruar që nuk janë aspak të përgatitur për të ju nënshtruar Provimit të Maturës Shtetërore.

4.1.2 A ndiheni i/e stresuar për Provimin e Maturës Shtetërore ?

Këshilli Rinor Kosovar duke pasur parasysh rrethanat në të cilat është vendosur organizimi i Provimit të Maturës Shtetërore dhe kanosjes së rrezikut nga Covid-19, vazhduar dhe me diskutim me Këshillin e Nxënësve të Kosovës kanë konsideruar si shumë të rëndësishme për rrethanat - dhe stresin e kandidatit/es për të ju nënshtruar testimit. Përveç faktit që një Provim i tillë dosido di të jetë stresues, shtuar dhe rrezikun shëndetësor KYC është orientuar të këtë pikë duke e konsideruar si shumë të rëndësishme për tu matur dhe marrë masa lehtësimi. Madje përmes një reagimi të lëshuar më datë 13 Maj 2020 menjëherë pas vendimit për mbajtjen dhe organizimin e Provimit të Maturës Shtetërore nga MASH – Këshilli i Nxënësve të Kosovës ka reaguar dhe adresuar çështjen dhe në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës. Kështu në pikën 3 të reagimit KNK thekson që “*Duke marrë parasysh, stresin që shkaktohet nga testimi tek nxënësit maturantë, kombinuar me stresin e rrezikshmërisë që mund të ju kanoset nga virusi Covid-19, dhe sipas UA Nr.34/2017 për Funksionimin Pedagogjik-Psikologjik në Shkolla, Neni 17, paragrafi 1 dhe 2, psikologu/ja ka për detyrë të vlerësoj dhe interpretoj çështjet që lidhen me të nxënësit dhe zhvillimin kognitiv, social, personal dhe emocional të nxënësve si dhe asiston dhe ofron ndihmë, identifikon dhe vlerëson nevojat e nxënësve. Në këtë rast duke u mbështetur në këtë rregullim, KNK rekomandon të gjendet*

RAPORT PËRMBLEDHËS I MONITORIMIT I PROVIMIT TË MATURËS SHTETËRORE

dhe ofrohet alternativë për konsulta psikologjike për se cilin/ën nxënës/e që mund të përjetoj stres të lartë për shkak të provimit të maturës shtetërore në situatë të pazakontë.”.

Ekzistimi i stresit vërtetohet edhe përmes përgjigjeve të respondentëve/eve prej të cilëve/ave 55% kanë dekluaruar që ndjehen shumë të stresuar për Provimin e Maturës Shtetërore, 21% janë deri diku të stresuar, 11% konsiderojnë se janë pak të stresuar dhe vetëm 3% prej tyre nuk ndjehen të stresuar.



Figura 14. Sa të stresuar ndjehen kandidatët/et për Provimin e Maturës Shtetërore

Përkundër reagimit dhe kërkesës për tu shtjelluar dhe shqyrtuar mundësia e lehtësimit të stresit që ndikon dhe në rezultatet si dhe mbarëvajtjen e testimit - nga organet institucionale një iniciativë specifike vetëm për nxënësit si kandidatë/e nuk është ndërmarrë.

4.1.3 A keni qenë të informuar me kohë për procedurat dhe organizimin e Provimit të Maturës Shtetërore ?

Neni 10, i Ligjit për Provimin e Maturës Shtetërore përcakton që Divizioni për Vlerësim, Standarde dhe Monitorim:

- “1.4. përgatit dhe publikon materiale bazë dhe informuese jo më vonë se në muajin tetor.
- 1.6. përgatit dhe shpérndan udhëzues për shkollat e mesme të larta dhe DKA për organizimin e programeve përgatitore për kandidatët që do t'i nënshtronhen provimit të maturës.
- 1.10. publikon materialet bazë, udhëzuesit informativ dhe rezultatet e provimit të maturës shtetërore në web faqen e MASHT.
- 1.11. krijon dhe procedon mënyrën e informimit rrith shpalljes dhe dokumenteve tjera për provimin e maturës në faqen elektronike dhe në media.”

Përgjatë monitorimeve ndër vite nga Këshilli Rinor Kosovar, është i njohur fakti që Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, saktësisht përmes DVSM ka publikuar broshura informuese për Provimin e Maturës Shtetëore me informata teknike e administrative, përderisa për vitin 2020 këto janë ofruar nga DVSM përmes Informata dhe Udhëzime për

RAPORT PËRMBLEDHËS I MONITORIMIT I PROVIMIT TË MATURËS SHTETËRORE

Kandidatin/en të publikuar në website të MASH. Konsiderohet të jenë ofruar informata poashtu përgjatë organizimeve të nivelit të decentralizuar pasi përgjegjësitetë për informim nga DVSM janë vendosur dhe në Udhëzuesin për Maturën Shtetërore – 2020.

Gjithsesi, se sa kanë qenë me kohë të informuar kandidatët/et shpjegohet përmes deklarimeve të tyre ku në fakt vetëm **8% prej tyre kanë deklaruar se janë** të informuar mbi procedurat dhe organizimin përdersia **14% prej tyre kanë deklaruar që e kanë lexuar Informata dhe Udhëzime për Kandidatët/et.** Ndërkaq, **25% kanë deklaruar që kanë qenë mesatërisht** të informuar, **6% që nuk kanë qenë** të informuar dhe **47% e respondentëve/eve janë përgjigjur që nuk e dinë.**




Figura 15. Kandidatët/et kanë qenë të informuar mbi procedurat dhe organizimin

4.1.4 A keni filluar të mbani para-përgatitje online për Provimin e Maturës Shtetërore ?

Sipas Ligjit për Provimin e Maturës Shtetërore, nen 12, paragrafi 1.3 përcaktohet që shkolla e mesme e lartë të përgatis dhe ofroj program mbështetës për Provimin e Maturës Shtetërore. Adresuar dhe në Udhëzuesin për Maturën Shtetërore – 2020 ndërlidhur dhe me Vendim të Ministrit Likaj nga MASH dhënë përmes **Njoftimit** të datës 13 qershori 2020, i cili njofton që “**mësimi plotësues i ambientimit dhe përgatitjes së nxënsëve për Testin e Maturës për klasët e 12-ta të mbahet në formën online (mësim në distancë)**”. Kësisoj nga të gjithë respondentët/et që i janë përgjigjur pyetësorit **32% e tyre kanë deklaruar që kanë filluar të mbajnë para-përgatitje** online të organizuara për Provimin e Maturës Shtetërore? Ndërkaq, **58% kanë deklaruar që nuk kanë mbajtur** para-përgatitje online të organizuara për Provimin e Maturës Shtetërore.

Para-përgatitjet për Provimin e Maturës Shtetërore janë cilësuar si të nevojshme sidomos këtë vit, për shkak të humbjeve të shpeshta të mësimit për këtë gjeneratë, nisur me grevën e mësim-dhënësve dhe pastaj me mbylljen e shkollave për shkak të pandemisë sado që mësimi i nxënë në kohën e mësimit online është vendosur nga KSHM dhe DVSM të mos përfshihet në kërkesat e Provimit të Maturës 2020.




Figura 16. Para-përgatitja online e kandidatëve/eve për Provimin e Maturës Shtetërore

4.1.5 A jeni duke mbajtur para-përgatitje online për secilën lëndë mësimore që do të përfshihet në Provimin e Maturës Shtetërore?

Sipas Udhëzuesit për Maturën Shtetërore 2020, dhe Komunikatës së KSHMS-së të 12 majit, Provimi i Maturës Shtetërore për vitin 2020 do të ketë gjithësej katër (4) lëndë me 100 kërkesa në total, 25 kërkesa për lëndë. Në test do përfshihen tri lëndët obligative (gjuhë amtare, gjuhë angleze dhe matematikë) dhe një lëndë zgjedhore (që përzgjidhet nga vet kandidati/ja nga mesi i lëndëve zgjedhore që do të ofrohen).

Andaj, pyetësori i lanësuar online, ka mëtuar të masë nëse kandidatët/et të cilët/at veçse kanë deklaruar që janë duke mbajtur para-përgatitjet online janë duke u përgatitur për të gjitha lëndët e përfshira. Kësosoj, rezultati i përgjigjeve tregon që 26% e kandidatëve/e janë para-përgatitur vetëm për një lëndë. 29% e tyre janë përgatitur për dy lëndë. 22% prej tyre për tre lëndë. Ndërkaq, përdallim nga përbledhja paraprake 23% e tyre kanë deklaruar që janë para-përgatitur në të tri lëndët.




Figura 17. Para-përgatitja online për lëndët e përfshira në testim

4.1.6 Sa janë efektive para-përgatitjet për Provimin e Maturës Shtetërore ?

Të mësuarit në formë dixhitale apo para-përgatitjet online në këtë rast, sado që mund të jenë të frekuentuara globalisht, në rastin e Kosovës e cila sistemin e arsimit e ka të bazuar në formë fizike standarde ka qenë ndër të tjera risi që ka pasur nevojë të adaptohet nga të gjithë hisedarët e edukimit. Ndër të tjera marrë parasysh kapacitetet e dobëta teknologjike dhe infrastrukturore të institucioneve publike arsimore ky adaptim ka ditur të jetë dhe më sfidues. Këshilli Rinor Kosovar përmes pyetësorit online është interesuar dhe mbi efektshmërinë e para-përgatitjeve online për Provimin e Maturës Shtetërore tek kandidatët/et. Si rrjedhojë, **58% e kandidatëve/eve** që kanë ndjekur para-përgatitjet për Provimin e Maturës Shtetërore online kanë deklaruar që këto ligjerata **kanë qenë deri diku të efektshme** karshi përgatitjes për testim dhe **28%** të tjerë/a kanë deklaruar që këto ligjerata në fakt **nuk kanë pasur aspak efekt** në përgatitjen e tyre për testim, dhe vetëm **14% prej tyre** i kanë cilësuar këto para-përgatitje si **shumë të efekshme**.



Figura 18. Sa të efektshme ishin para-përgatitjet

4.1.7 A keni ndjekur mësim online ?

Përmes **Udhëzime për DKA-të për mësim online** MASH-i u ka kërkuar DKA-ve të fillojnë përgatitjet dhe inkurajimin e shkollave të zhvillojnë mësimin në distancë me nxënësit në mënyrë të decentralizuar në nivel shkolle dhe me mësimdhënësit në nivel klase. Do të thotë për dallim nga niveli i klasëve 1-9 ku mësimi online është ofruar përmes platformës digitale e-mësimi dhe është publikuar në kanalet e RTK 1 dhe RTK 4 në nivel nacional, për institucionet e nivelit 3 të ISCED apo në gjuhën e njohur si shkollat e mesme është inkurajuar zhvillimi dhe organizimi i mësimit online në formë të decentralizuar. Përveç kësaj përmes dokumentit të lëshuar nga MASH - **Detyrat dhe Përgjegjësitet për Realizimin e Mësimit në Distancë** theksohet që : “*Për realizimin me sukses të mësimit në distancë, kërkohet angazhimi i plotë i autoriteteteve, institutioneve dhe i personelit arsimor në Kosovë. Edhepse është ndërpërre mësimi, vazhdojnë obligimet profesionale e kontraktuale të të gjitha instancave e individëve të sistemit arsimor Kosovar – megjithëse në rrethana e formë tjetër të angazhimit për të siguruar mirëqenien shëndetësore të nxënësve, studentëve e të personelit në kushte të pandemisë COVID – 19. Realizimi i mësimit në distancë nuk është angazhim vullnetar por përbashkje e obligimeve ligjore e profesionale të punitoreve e të autoriteteteve arsimore.*” Pra, organizimi është inkurajuar dhe i është lënë në dorë DKA-ve dhe shkollave apo

mësimdhënësve në nivelin e klasës dhe përmes udhëzimeve u janë ofruar disa hapa nga MASH se si do të mund ta organizonin procesin.

Në këtë rast, sipas përgjigjeve të respondentëve kuptohet që një numër i madh i nxënësve kanë ndjekur mësimin online apo më saktësisht **90% e tyre kanë pasur qasje në mësim online** të organizuar nga shkolla e tyre. Mirëpo **10% të respondentëve/eve** kanë deklaruar që **nuk kanë ndjekur mësim online**.




Figura 19. Ndjekja e mësimit online

4.1.8 Sa shpesh keni ndjekur mësimin online ?

Pikërisht për shkak të sistemimit dhe adaptimit të mësim-dhënies dhe të mësim-nxënies në formë digitale pasë dhe parasysh pamundësinë e menaxhimit apo funksionimit të nivelit të lartë të mësimit në rrethana mbi të gjitha stresuese dhe kaotike, menaxhimi i mësimit online në krahasim me përgjigjet e respondentëve del të jetë i kënaqshëm. Për më tepër përmes dokumentit Detyrat dhe Përgjegjësítë për Realizimin e Mësimit në Distancë, MASH specifikon që: **“Kujdestarët e klasave 6-12 janë të obliguar të vazhdojnë angazhimin në kryerjen e detyrave të veta profesionale për realizimin e mësimit online.** Kujdestarët e klasave organizojnë grupe virtuale me nxënësit e paralelës së vet. Të gjithë mësimdhënësit e angazhuar në punë me këtë klasë organizohen rreth kujdestarit të klasës. **Kujdestari i klasës përcjellë orarin e mësimeve online dhe komunikon me prindërit për angazhimin e rregullt të nxënësve.**” Përveç kësaj, përmes Udhëzime për DKA-të për realizim të mësimit online seksioni i Reformave Plotësuese, paragrafi 1 për të lehtësuar organizimin për shkollat që nuk kanë resurset e mjaftueshme njerëzore dhe teknologjike kanë përcaktuar format si: 1. Realizimi i mësimit online të jetë i fokusuar në disa lëndë të përgjithshme: “(i) Gjimnazet – zbatimi i kufizuar në lëndët kryesore (gjuhë, matematikë, shkenca natyrore dhe lëndë shoqërore); (ii) Shkollat profesionale: Realizojnë mësimin online në lëndët e përgjithshme (gjuhë amtare, matematikë, gjuhë e huaj e të tjera)..”

RAPORT PËRMBLEDHËS I MONITORIMIT I PROVIMIT TË MATURËS SHTETËRORE

Në këtë rast sipas përgjigjeve të respondentëve/ev, **56%** e nxënësve kanë ndjekur të gjitha orët mësimore të ofruara, përderisa **24%** e tyre kanë dekluar që kanë ndjekur shumicën e orëve mësimore por jo të gjitha, përderisa **10%** kanë ndjekur shumë pak orë mësimore.



Figura 20. Sa shpesh është ndjekur mësimi online

4.1.9 Sa ka qenë efektiv mësimi online ?

MASH përmes udhëzimeve dhe dokumenteve përcjellëse të lansuara, kërkon angazhimin për lehtësim të mësimit online, saktësisht duke kërkuar nga secila palë t'i kryej detyrat dhe përgjegjësitë e veta profesionale me fokus në realizimin e mësimit online. Përmes dokumentetit Detyrat dhe përgjegjësitë për realizimin e mësimit në distancë nga mësimdhënësit është kërkuar: “*përcjellja e mësimit online, përkujdesja për aktivizimin e rregullt të nxënësve, përkujdesjen dhe përcjelljen e kryerjes së detyrave të shtëpisë, këshillimin e nxënsve për tejkalimin e sfidave, shpjegimin e pjesëve më të vështira, mbajtjen e evidencave e të tjera*”

Dosido, vetëm **9%** e nxënësve që kanë ndjekur mësimin online e kanë konsideruar atë **si shumë efektiv** në mësim-nxënësie përdersia **57%** e nxënësve konsiderojnë që mësimi online ka qenë **deri diku efektiv** dhe ndër të tjera **24%** prej tyre vlerësojnë mësimin online si **aspak efektiv**.




Figura 21. Efektshmëria e mësimit online

4.1.10 A keni pasur të vështirë qasjen në platformat digitale për mësimin online ?

Në Udhëzime për Drejtoritë Komunale të Arsimit për realizim të mësimin online në seksionin Udhëzime për DKA-të dhe Shkollat për Kushtet teknologjike: kërkohet njohja e aplikacioneve si: Zoom, Microsoft Teams. Mësimdhënësit ose shkollat mund të përcaktohen edhe për aplikacione të tjera si për shembull Facebook, Google Meet, Google Classroom e të tjera.

Përdorimi i këtyre platformave digitale është lansuar dhe bërë i njohur si sistem mësimi kryesisht dhe vetëm gjatë pandemisë Covid-19 për shkak të rrethanave të krijuara. Për një shfrytëzim sa më efektëshëm të aspektit digjital në të njëjtën kohë kërkohet shfrytëzim interneti (gjë që është pa si vështirësi në Udhëzime për Mësimin Online) si dhe kapacitete teknologjike e infrastrukturore në atë drejtim.

Në këtë rast, nxënësit të cilët/at kanë ndjekur mësimin online – vetëm 27% e tyre kanë deklaruar që nuk kanë pasur vështirësi në qasje në këto platforma digitale, përderisa 53% e nxënësve kanë vlerësuar që deri diku dhe kanë pasur vështirësi në qasje si dhe 10% e tyre konsiderojnë si të vështirë qasjen në këto platforma digitale.




Figura 22. Qasja në platforma digitale

4.2 Seksion i integruar i pyetësorit: sa të vërteta janë deklaratat më poshtë

Ky seksion ka për qëllim të masë efektshmërinë e mësimit online në aspektin e tij të gjithëpërfshirjes, përgjegjësinë dhe interesimin e nxënësve, vlerësimin online dhe lidhjen e këtij vlerësimi me dukurinë e kopjimit në Provimin e Maturës Shtetërore. Rrjedhimisht më poshtë do të paraqiten vetëm rezultatet e përgjigjeve të nxënësve si respondentë të pyetësorit për Para-përgatitjet për Provimin e Maturës Shtetërore.

4.2.1 Unë njohë një shok/shoqe i/e cili/a nuk ka mund të ndjek mësimin online shkaku i mungesës së paisjeve teknologjike.

Situata e krijuar nga pandemia Covid-19, konsiderohet përgjithësisht në publik si kohë e paraqitjes së pa-barazive dhe mundësive jo të barabarta për të gjithë/a nxënësit e kategorive të ndryshme socio-ekonomike apo dhe komuniteteve të ndryshme. Mbi të gjitha monitorimi i situatës së mësimit online vetëm nga terreni i Këshillit Rinor Kosovar ka treguar që shumë nxënës nuk kanë arritur të qasen në mësimin online pikërisht për shkak të mungesës së paisjeve teknologjike në shtëpi. E njëjtë situatë paraqitet dhe në përgjigjet e respondentëve të pyetësorit prej të cilëve/ave 36.4% kanë deklaruar që është plotësisht e vërtetë që ata/ato njojin të paktën një shok/shoqe që nuk ka mundur ta ndjek mësimin online për shkak të kësaj mungese, 23.6% nën këtë vazhdimësi kanë deklaruar që kjo është deri diku është e vërtetë dhe nga këto përgjigje vetëm 22.3% kanë thënë që kjo deklaratë për ta është plotësisht e pavërtetë ose thënë ndryshtë nuk njojin ndonjë shok/shoqe që nuk është qasur në mësimin online për shkak të mungesës së paisjeve teknologjike.

RAPORT PËRMBLEDHËS I MONITORIMIT I PROVIMIT TË MATURËS SHTETËRORE



Figura 23. Deklarata e respondentit/es: Unë njohë një shok/shoqe i/e cili/a nuk ka mund të ndjek mësimin online shkaku i mungesës së paisjeve teknologjike

4.2.2 Jam qasur në mësim online ndonjëherë vetëm për të konfirmuar pjesëmarrjen, pasaj kam vazhduar me ndonjë aktivitet tjetër.

Menaxhimi i interesit të nxënësve për mësim-nxënësie mund të jetë i vështirë fizikisht e posaqërisht përmes formës digitale kur mund të ofrohen arsyetime të ndryshme vetëm për të mos ndjekur mësimin. Ndër të tjera, elementet bazë të pajisjes elektronike si kamera dhe mikrofoni për të mundësuar angazhim të nxënësit në platforma digitale nuk mund të kontrollohen nga mësim-dhënësit/et apo pjesëtarët e tjerë të fushës së arsimit, e të njëjtën kohë preteksti i mos-funksionimit të tyre ka mundur të përdoret si arsyetimi më i shpeshtë për të mos u angazhuar plotësish në mësim-nxënësie. Prandaj, pyetësori ka vlerësuar dhe interesin e nxënësit/et karshi efektshmërisë në mësim online dhe rrejdhimisht përgjigjet rezultojnë si: **43% e tyre thonë që është plotësish e pavërtetë** – apo që kanë ndjekur mësimin online gjatë tërë kohës, përderisa **19% e deklarojnë një dukuri të tillë si plotësish të vërtetë** pasuar dhe **15% të atyre që e deklarojnë këtë dukuri si deri diku të vërtetë**.



Figura 24. Deklarata e respondentit/es: Jam qasur në mësim online ndonjëherë vetëm për të konfirmuar pjesëmarrjen, pasaj kam vazhduar me ndonjë aktivitet tjetër

4.2.3 Unë mendoj që mësim-dhënësit kanë qenë të përgatitur për të dhënë mësim në platforma digitale.

Sipas Udhëzime për DKA-të për realizimin e mësimit online për shkollat e mesme, në seksionin udhëzime për DKA-të dhe Shkollat, faqe 2, ndër të tjera thuhet që “*Të gjithë mësimdhënsësit e shkollave të mesme të larta në Kosovë kanë licencë nga qeveria e Kosovës respektivisht nga Agjencia e Shoqërisë Informatike (ASHI). Në anën tjetër, shumica e përdoruesve të Facebook, përfshirë mësimdhënësit, ose janë pjesë e ndonjë grupei të mbyllur në facebook ose kanë krijuar vet ndonjë grup të tillë. Nga mësimdhënësit do të kërkohej të krijonin grupe të tillë me nxënësit dhe të punojnë në zbatimin e mësimit online*” poashtu thuhet: “*Vërejtje: Kërkohet nga DKA*

dhe autoritetet përkatëse arsimore që të udhëzojnë mësimdhënësit në mënyrë strikte për përdorimin e këtyre platformave **në përputhje me kriteret më të larta etike të profesionit.** si dhe paragrafi i fundit brenda këtij seksioni përcakton: “*MASHTI mund të ofrojë trajnime për mësuesit nëpërmjet të webinareve të ndryshme, video-materialeve promovuese, përkrahjes teknologjike – sipas nevojës dhe nëpërmjet të sigurimit të qasjes në internet*”.

Prandaj, përmes këtij pyetësori ka qenë e rëndësishme të matet dhe mendimi i nxënësve/eve karshi përgatitjes së mësim-dhënësve/eve të cilët/at kanë qenë të obliguar të vazhdojnë kryerjen e detyrimeve të veta profesionale duke u fokusuar në lehëtsimin e realizimit të mësimit online - sipas Detyrat dhe Përgjegjësitetë për realizim të mësimit në distancë.

Rrjedhimisht, **23% e respondentëve** e mendojnë si **plotësisht të vërtetë** faktin që mësim-dhënësit/et kanë **qenë të përgatitur** për të dhënë mësim online. Mirëpo pjesa tjeter e përgjigjeve faktikisht, e vë mësim-dhënësin/en në një pozitë jo mjaftueshëm të përgatitur pasi që **44% e nxënësve mendojnë** që deri diku mësim-dhënësi/ja **ka qenë e përgatitur**, përderisa **11% konsiderojnë** që mësimdhënësi/ja e tij/saj ka qenë e **plotësisht e pa-përgatitur për mësim-dhënie online**.




Figura 25. Deklarata e respondentit/es: Unë mendoj që mësimdhënësit kanë qenë të përgatitur për të dhënë mësim në platforma digitale.

4.3 Mbarëvajtja e procesit të provimit të maturës shtetërore

Plotësimi i raportit përbledhës të monitorimit të provimit të maturës shtetërore dhe me këndvështrim të kandidatit/es për mbarëvajtjen e procesit të provimit të maturës, pas pasqyrës të drejtëpërdrejtë të monitoruesëve/eve të marrë nga tereni poashtu konsiderohet i një rëndësie të veçantë për të përquar informatë dhe ndikuar rekomandimin apo përmirësimin e këtij procesi për të ardhmen. Për të arritur këtë qëllim monitoruesit/et e Këshillit Rinor Kosovar, zakonisht (viteve të kaluara) intervistojnë kanidatët/et menjëherë pas përfundimit të Provimit të Maturës Shtetërore në qendrën përkatëse. Mirëpo për Provimit e Maturës Shtetëore -2020 për shkak të rrethanave dhe për të mos shtuar rrezikun. Ky pyetësori është i hapur për një periudhë 1 javore për të mbledhur përgjigjet e respondentëve. Pyetësori është i përpiluar në formë të pyetjeve të myllura dhe ka vetëm një pyetje të hapur. Gjithësesi këtij pyetësori i janë përgjigjur **606 respondentë** apo kandidatë/e të provimit të maturës shtetërore – 2020 nga komuna të ndryshme dominuar kryesisht nga regionet e mëdha si: **Prishtinë (122**

respondentë apo 22.30%), Ferizaj (62 respondentë apo 11.33%), Pejë (45 respondentë apo 8.23%), Mitrovicë (37 respondentë apo 6.76%), Prizren(34 respondentë apo 6.22%). Prej të cilëve/ave 69% janë respondentë që kanë ndjekur mësimin në Gjimanz, ndërkaq, 31% të tjerë në shkolla profesionale.




Figura 26. Numri i respondentëve për komunë

Pyetësori ka kërkuar në vazhdim nga respondentët të ju përgjigjen deklaratave përmes vlerësimit me shkallë Likert nga **1 deri në 5**, ku me **1** referencoitet përgjigja si **aspak e vërtetë** ndërkaq me **5 si shumë e vërtetë**.

Kjo përmbledhje plotësish paraqet të dhënat, opinionet, mendimet dhe përceptimet e nxënësve si kandidatë të Provimit të Maturës Shtetërore.

4.3.1 Ndjej se kam pasur informata të sakta dhe në kohë rreth mbajtjes së Provimit të Maturës Shtetërore ?

Bazuar mbi të drejtën e nxënësit/es si kandidat/e i/e provimit të maturës shtetëore për të u pajisur me kohë me informata të sakta për rrjedhshmërinë dhe të gjitha çështjet teknike dhe administrative në lidhje me mbarëvajtjen e procesit që derivojnë nga ligjet dhe aktet nënligjore në fuqi. Të cilat si procedurë dhe obiligime institucionale janë përshkruar në pjesën e parë të raportit përmbledhës, ky pyetësor matë nëse këto informata nga përspektiva e nxënësitsit kanë arritur me kohë tek ai/ajo. Në këtë rast, **18.8%** e respondentëve konsiderojnë që informatat i kanë marrë me kohë apo konsiderojnë këtë deklaratë si shumë të vërtetë përderisa përgjigjet e tjera rezulojnë në nivele më të ulta deri tek **ajo 14% që deklarojnë që nuk e kanë marrë informatën me kohë**. Përgjithësisht shumica e respondentëve, nuk mendojnë që kanë qenë të informuar plotësish me kohë.

RAPORT PËRMBLEDHËS I MONITORIMIT I PROVIMIT TË MATURËS SHTETËRORE




Figura 27. Deklarata e repodentëve (1-5): Ndjej se kam pasur informata të sakta dhe në kohë

4.3.2 Pyetjet në test kanë qenë në përputhje me plan-programin mësimor

Sipas Udhëzuesit për Maturën Shtetërore, testi i maturës do të ketë gjithsej 100 kërkesa (pyetje, detyra), nga 25 kërkesa për secilën nga katër lëndët obligative (gjuhë amtare, gjuhë angleze dhe matematikë) dhe një lëndë zgjedhore (që përgjidhet nga vet kandidati/ja nga mesi i lëndëve zgjedhore që ofrohen). Në anën tjetër, përgjatë tërë viteve të monitorimit të procesit të provimit të maturës shtetërore dhe përgjatë çdo diskutimi me nxënësit vihet në pahë nga ana e tyre që kërkesat (pyetjet) e testit nuk përkijnë gjithmonë me plan-programin mësimor. Pothuajse i njëjti rezultat është vendosur edhe përmes këtij pyetësori ku vetëm **15.8% e repodentëve e kanë quajtur shumë të vërtetë deklaratën** që pyetjet kanë qenë në përputhje me plan-programin mësimor. Përderisa, **29.2% janë rënditur në shkallën 3** të përgjigjes dhe **15.7% në shkallën 1** apo e kanë **referencuar si aspak** të vërtetë deklaratën që pyetjet kanë qenë në përputhje me plan-programin mësimor.



Figura 28. Deklarata e respondentëve (1-5): Pyetjet në test kanë qenë në përputhje me plan-programin mësimor.

Ndër të tjera në pyetjen e hapur për komente shtesë disa respondentë kanë komentuar:


1. "Perpilimi i pyetjeve ka qene i pakuptueshem me raste...";
2. "Pyetjet ishin konfuze dhe me shume tekste sidoms lenda e gjuhes angleze";
3. "Pyetjet te jene vetem nga librat shkollor";
4. "Mos qitni sene qe nuk i mesojme se qashtu po deshtojme";
5. "Kisha dëshiru qe pyetjet të përpilohen në bazë të asaj që shpjegohet në shkolla dhe jo të përpilohen jasht atyre qe kemi mësuar";

6. Shume gjera kane qene jashtë temes shkollore qe ne mesojme, kam pasur shume vershtirsi ne matematike dhe shume pytje ne informatike nuk i kemi zhvilluar fare ne shkolle;
7. Të mos qesin pyetje te cilat jane jasht librit sic edhe ka ndodh kesaj here;
8. Verejtje: Ka pasur shume pyetje ne testin e matures te cilat nuk kane qene ne planprogram dhe qe as nuk gjenden neper libra. Ky fakt na ka penalizuar te gjithe nxenesve;
9. Pyetjet ishin të vështira dhe shumica jashtë plan-programit të mësimit!;
10. Pyetjet te jene ne perputhje me planprogramin mesimor pasi nuk ishin aspak te njejta!!
11. Te mirren pytjet nga ajo qe kemi mesuar;
12. Une kam pasur lenden zgjedhore biologji, por pyetjet nuk kane qene te plan-programit te gjimnazit te shkencave natyrore , mirepo pytetjet kan qene nga biologja qe mesohet ne shkollen e mesme te mjekesise;
13. Rekomandoj që Gjimnazit filologjik Eqrem Çabej ti hiqet lënda e matematikes ne maturen shteterore sepse ai gjimnaz ka matematike vetem ne klasen e 10-te dhe me duket shume e paarsyeshme qe nxenesit te testohen per ate lende kur kane vetem ne klasen e 10-te dhe ne vend te matematikes te futet gjuha gjermane ose lenda e filozofise.”

4.3.4 Konsideroj se ambienti i mbajtjes së testit ka qenë i përshtatshëm

Sipas Ligjit për Provimin e Maturës Shtetërore, neni 20, parografi 2, përcaktohet: “Lokalet ku mbahet provimi i maturës duhet t'i plotësojnë këto kritere: 4.1. të kenë hapësirë të mjaftueshme për mbajtjen e provimit pa pengesë, 4.2. të kenë ndriçim dhe ajrosje të mjaftueshme, 2.3. të këtë materiale informuese dhe udhëzuese për mbarëvajtjen e provimit.”

Megjithatë monitorimet paraprake si dhe këtë vit tregohet që lokacionet ku mbahet provimi kryesisht janë institucionet shkollore në klasa të ndara ose salsa të cilat në shumicën e rasteve plotësojnë kriteret e vendosura. Në këtë rast, dhe kësaj deklarate një numër më i madh i respondentëve i janë përgjigjur me **shumë e vërtetë apo saktësish 44.4%** e tyre përderisa në krahasim **11.2% konsiderojnë këtë deklaratë si aspak e vërtetë.**



RAPORT PËRMBLEDHËS I MONITORIMIT I PROVIMIT TË MATURËS SHTETËRORE

Figura 29. Deklarata e repodenjtëve (1-5): Konsideroj se ambienti i mbajtjes së testit ka qenë i përshtatshëm

4.3.5 Klasa/Hapësira ku është mbajtur testi ka qenë e dezinfektuar

Përveç kriterieve bazë të ambientit të testimt, këtë vit për shkak të virusit COVID-19, dhe masave të rekomanduara nga IKSHPK, zbatuar dhe në Udhëzime për Maturën Shtetërore – “duhet të dezinfektohen (secila klasë mësimi) drejtori ne kordinim me DKA duhet të sigurojnë dezinfektues në secilën sallë dhe në hyrje të objektit.”. Rrjedhimisht, sipas përspektivës së kandidatit/es, në 35.5% të rasteve deklarata për ta qëndron si shumë e vërtetë, mirëpo, përgjigjet e respondentëve në shkallët e tjera të deklaratës variojnë në mes të 17% - shkalla 4, 18% - shkalla 3, 10.6% - shkalla 2 dhe 19% -shkalla 1 apo ndryshe deklarata cilësohet si aspak e vërtetë.



Figura 30. Deklarata e repodenjtëve (1-5): Klasa/Hapësira ku është mbajtur testi ka qenë e dezinfektuar

4.3.6 Është respektuar distanca fizike mes nxënësve

Sipas Udhëzime për Maturën Shtetërore -2020 që u ofrohen hisedarëve për menaxhim dhe respektim të distancës si masë mbrojtëse nga kandidatët “*Është shumë e rëndëshme që gjatë procesit të testit, kandidatët nga hyrja në objekt e deri tek dalja nga objekti, të ruejn distance prej 2 metra*”, por dhe përmes Informata, Udhëzime dhe Rregulla për kanidatët/et – në seksionin e Rregullat që lidhen me mbrojtje nga COVID-19, “*kandidatët/et janë të detyruar që të mbajnë distancë 2 metra me gjithë personat e tjerë*”. Në këtë rast nga perspektiva e nxënësve shohim rrjedhimisht shkelje të kësaj mase që konsiderohet si jashtëzakonisht e rëndësishme. 32.2% e respondentëve deklaratën e konsiderojnë si **shumë të vërtetë** apo më saktësisht në këto raste është mbajtur distanca fizike por **33.8% nuk pajtohen fare** me një deklaratë të tillë. Përqindja kontribuohet dhe me shkallën 2 të pajtueshmërisë ose 12.4 % dhe shkallën 3 apo 12.7%.



RAPORT PËRMBLEDHËS I MONITORIMIT I PROVIMIT TË MATURËS SHTETËRORE

Figura 31. Deklarata e repodentëve (1-5): Është respektuar distanca fizike mes nxënësve

4.3.7 Sa nxënës ishit në klasën ku është mbajtur testi ?

Sipas Udhëzime për Maturën Shtetërore 2020 – “Secila sallë duhet të ketë më shumti 12 banka dhe 12 karrika plus dy banka dhe 2 karrika për adminisruesin dhe mbikqyrësin e testimit. Distanca në mes të bankave duhet të jetë e njëjtë për të gjitha klasat si dhe distanca mes nxënësve duhet të jetë optimale.” Rrjedhimisht, përveç asaj që është vërejtur nga monitorimi në terren, kandidatët/et vlerësojnë se në **66%** të rasteve numri i nxënësve **në klasë ka qenë 12 persona**, saktë sa është përcaktuar. Mirëpo, në **13% të rasteve** janë pozicionuar më shumë nxënës në klasë duke variuar mes **13 nxënësish** dhe **20 në një rast**.



Figura 32. Deklarata e repodentëve: Sa nxënës ishit në klasë?

4.3.8 Maskat janë mbajtur nga të gjithë nxënësit në klasë, gjatë tërë kohës.

Masë tjetër mbrotjeje kundër COVID-19 nga IKSHPK që është adaptuar nga institucionet e organizimit të procesit të Maturës Shtetërore është dhe vendosja e maskave e masë ndër dokumentet e tjera në Informata, Udhëzime dhe Rregulla për kandidatët/et detyron këta të fundit *të mbajnë maskë, duke mbuluar gojën, hundën dhe mjekrën*.

Sipas përgjigjeve të respondentëve, **41.9% e tyre** konsiderojnë se është shumë e vërtetë deklarata se nxënësit/et i kanë mbajtur maskat. Por në anën tjetër një numër tjetër i konsiderueshëm kategorizon përgjigjen e tyre ndaj deklatës në shkallë më të vogla, prej ku **17% përgjegjin shkallën 4 të pajtueshmërisë, 14% shkallën 3 të pajtueshmërisë, 10.2% shkallën 2 të pajtueshmërisë dhe 16.8% mendojnë që kjo deklaratë nuk është aspak e vërtetë apo për ta përkthyer nuk qëndron.**




Figura 33. Deklarata e repodentëve (1-5): Maskat janë mbajtur nga të gjithë nxënësit

4.3.9 Jam lejuar të bartë dhe përdor telefonin me qëllim të arritjes së perfomacës më të mirë në test!

Sipas dokumenteve dhe akteve ligjore e nën-ligjore MASH dhe organet e tjera kompetente kanë të drejtë të kufizojnë nxënësit/et në përdorim të telefonave. Madje përvojat para-prake dhe monitorimi i këtij viti në terren tregon që nxënësve u është kërkuar në hyrje të dorëzojnë telefonat. Kjo si historik vjen dhe si pasojë e keq-përdorimeve dhe trendit të publikimit të testeve ende pa filluar mirë testim - online në grupe të ndryshme të rrjetave sociale me ç'rast masoivisht mundësohet kopjimi i kandidatëve në test. Madje saktësisht verifikohet si rregull, përmes Udhëzime, Informata dhe Rregulla për kandidatët/et – si rregulla të përcaktuara gjatë testimit janë dhe: - a) “Gjatë testimit kandidatët mund të kenë mbi bankë vetëm testin, Fletë-përgjigjen, lapsin, ujin, faculetat e letrës dhe mjetin e identifikimit”; b) Gjatë testimit kandidatët nuk mund të përdorin asnjë mjet ndihme (si telefon, kalkulator apo pajisje e mjet tjetër ndihmës”); c) “Testi nuk lejohet të merret me vete, të fotografohet, të kopjohet apo të publikohet nga kandidatët në asnjë formë”.

Një dukuri e tillë e përdorimit të telefonit nga nxënësit përfundon a publikuar testin online, ndër vite konsiderohet si shumë e dëmshme përfundon procesin e Provimit të Maturës Shtetërore, dhe është një ndër dukuritë më të monitoruara të Këshillit Rinor Kosovar, e cila çështje këtë vit nuk ka mundur të krijojë pasqyrë nga monitorimi në terren përfundohet se pyetësori i monitorimit ka qenë i determinuar nga DVSM dhe nuk janë lejuar ndërhyrje. Mirëpo, është intergruar në këtë pjesë të pyetësorit pavarësisht besueshmërisë në përgjigje direkte nga vet përdoruesi/ja si kandidat/e i/e provimit të maturës shtetërore.

Rrjedhimisht, nga të gjithë/a respondentët/et 79.4% e tyre konsiderojnë këtë deklaratë si aspak të vërtetë, përderisa mes shkallësh 6.8% e konsiderojnë këtë deklaratë si shumë të vërtetë.



Figura 34. Deklarata e repodenjtëve (1-5): Jam lejuar të bartë telefonin me qëllim arritjes më të lartë të perfomancës

4.3.10 Komisioni dhe stafi administrues/mbikëqyrës kanë qenë korrekt ndaj të gjithëve/ave.

Këshilli Rinor Kosovar ka monitoruar Provimin e Maturës Shtetërore, 8 herë gjatë viteve të fundit, duke përcjellur dhe raportuar kështu mbi çështje të ndryshme në lidhje me procesin.

RAPORT PËRMBLEDHËS I MONITORIMIT I PROVIMIT TË MATURËS SHTETËRORE

Vazhdimesht në sipërfaqe kanë qenë të shfaqura rastet kur nxënësit/et kryesisht mendojnë që ndaj tyre bëhet padrejtësi nga klasa në klasë, varësisht qëndrimit dhe respektimit të rregullave nga ana e palëve të përfshira për administrim dhe mbikqyrja e Provimit të Maturës Shtetërore. Këto padrejtësi ndërlidhen shpesh me faktorin kopjim apo bashkëpunim si dhe ndihmesë nga vet administriesit në plotësim të përgjigjeve të sakta të testit. Do të thotë, eksperiencia, dhe njohja shumë e mirë e procesit tashmë nga Këshilli Rinor Kosovar, tregon se kopjimi dhe bashkëpunimi si fenomenës normalizuar në masë të madhe, për shkak të zërjes vend të fenomenit për çdo vit. Saktësohet kështu të paktën për 8 vitet e fundit siç është raportuar nga monitorimi i procesit. Andaj, shumë prej kandidatëve gjithmonë kanë argumentuar vendosjen e standardeve të dyfishta, mbi bazën e korrektilisë meqë në qendra, e klasa të ndryshme testimi dominon rregulla sipas kërkesës institucionale, përderisa në qendra, e klasa të tjera të testimit nuk ka kontroll rigoroz karshi fenomenit kopjim. Dhe kur kjo ndodhë, kandidatët/et në shumicën e rasteve, e nënkuptojnë situatën si një pa-drejtësi. Rrjedhimisht, karshi kësaj pyetje, **50.3% e respondentëve** kanë deklaratën e kanë konsideruar si të vërtetë. Mirëpo 50% e repodenjtëve të mbetur, janë nivelizuar në shkallë më të ulta të pajtimit me deklaratën, apo më saktësisht **14.4% në 4, 9.4% në 3, 6.6% në dy** dhe **19.3% - 1** apo që nënkupton se nuk janë pajtuar aspak me deklaratën.




Figura 35. Deklarata e repodenjtëve (1-5): Komisioni dhe stafi administrues/mbikëqyrës kanë qenë korrekt ndaj të gjithëve/ave

Më poshtë janë listuar disa komente të respondentëve karshi kësaj pyetje:

1. “Padrejesia eshte në kulm duke i lënë disa nxënës te kopjojn e disa jo. Po ashtu edhe nxenesit e dalluar nuk mund ti din 70-80-90% pytjet sepse janë disa shume te veshtira;
2. TMERR! shume padrejtsi shuuuuume;
3. Ka pasur shume padrejtesi nga Egzaminuesit e Komunes se Gjilanit;
4. Komisioneret duhet te jene me te sakt dhe per secilen klase te perdoren rregullat e njejta;
5. Nuk ka pasur mbajtje te rregullave nga disa administrures. Perderisa disa nga ta kane bere shume leshime që tregon se rezultati i testit nuk do te jete real tek nxenesit.”

4.3.11 Kam bashkëpunuar/kopjuar me nxënësit e tjerë në klasë.

Bashkëpunimi dhe kopjimi, janë dy elementet më shqetësuese si sjellje e nxënësve përgjatë testimit të cilat përgjithësisht e dëmtojnë Provimin e Maturës Shtetërore si proces. Kopjimi si fenomen është prezent dhe i evidentueshëm nga monitorues e vëzhgues të provimit të maturës shtetërore, por dhe nga vet institucionet kompetente. Prandaj dhe forma të parandalimin janë ndërmarrë nga MASh të cilët sipas Informata, Udhëzime dhe Rregulla për kandidatët/et: a) "Gjatë testimit kandidatët duhet të mbajnë qetësi maksimale. Nuk lejohen pëshpëritje, të folur me zë, lëvizje që prishin qetësinë në klasë apo në sallën e testimit, etj." b) *Gjatë testimit kandidatët nuk guxojnë të kthejnë kokën apo të kthehen anash më shumë se 45 gradë;* c) *Gjatë testimit kandidatët nuk guxojnë të provojnë të flasin me njëri-tjetrin, të kopojnë nga njëri-tjetri apo të ndihmojnë njëri-tjetrin;* d) "*Testi nuk lejohet të merret me vete, të fotografohet, të kopjohet apo të publikohet nga kandidatët në asnje formë*". Ndërkaq, në rast të mos-respektimit sipas Ligjit për Provimin e Maturës Shtetërore, paragrafi 3 i dispozitave ligjore parashihet që: "*Kandidatët të cilët gjatë provimit të maturës shtetërore shkelin rregullat e mirësjelljes, të përcaktuara me udhëzues përkatës për provim, ju anulohet testi i maturës dhe të njëjtët i nënshtronen provimit në afatet vijuese*". Poashtu, sipas UA për detyrat dhe përgjegjësitë e administruesit të provimit të maturës shtetërore, neni 3, paragrafi 2, 3 dhe 4 përcaktohet që: "*Administruesi ka për detyrë të mos lejoj kandidatin të kopjoj nëasnje formë;*" "*të mos lejoj kandidatin të përdor celularin apo ndonjë pajisje tjetër*".

51.3% e respondentëve konsiderojnë që kjo deklaratë nuk është aspak e vërtetë. Ndërsa, 13.5% e të gjithë/a respondentëve e konsiderojnë deklaratën si shumë të vërtetë.

Meqë kopjimi paraqitet si fenomen i përvitshëm gjatë procesit të Provimit të Maturës Shtetërore, parandaj Këshilli Rinor Kosovar gjatë monitorimit në terren i ka kushtuar gjithmonë një rëndësi të veçantë. Këtë vit është përfshirë vetëm në pyetësori e këndvështrimit të kandidatëve/eve pasi që pyetësori i monitorimit në terren ka qenë i determinuar nga DVSM dhe nuk janë lejuar ndërhyrje.



Figura 36. Deklarata e repodenjtëve (1-5): Jemi lejuar të bashkëpunojmë/kopjojmë me nxënësit e tjerë në klasë

4.3.12 Administruesit i janë përbajturi rregullave për maturën shtetërore si dhe udhëzimeve nga Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës

RAPORT PËRMBLEDHËS I MONITORIMIT I PROVIMIT TË MATURËS SHTETËRORE

Detyrat dhe përgjegjësitë e administruesit përcaktohen përmes UA për detyrat dhe përgjegjësitë e administruesit, specifisht për mbarëvajtjen e procesit të mbarëvajtjes mësimore si dhe mos-respektimi i këtyre rregullave sanksionohet përmes dispozitave ndëshkuese të Ligjit për Provimin e Maturës Shtetërore. Përveç kësaj, MASH përmes Udhëzime për Maturën Shtetërore -2020 ka përcaktuar dhe masat dhe përgjegjësitë e shtuara të administruesit/es përkitazi me masat për mbrojtje nga Covid-29.

Në këtë rast, **48%** e respondentëve mendojnë që **administruesit u janë përmbajtur rregullave** për maturën shtetërore dhe udhëzimeve, përdersia një përqindje prej **10.4 mendojnë** që kjo deklaratë **nuk është aspak e vërtetë**.



Figura 37. Deklarata e respondentëve (1-5): Administruesit u janë përmbajtur rregullave

4.3.13 Kam pasur vështirësi të kontrolloj stresin para dhe gjatë testimit

Nxënësit/et kandidatë/e të Provimit të Maturës Shtetërore edhe përmes reagimit të Këshillit të Nxënësve para periudhës së mbajtjes së testit kanë deklaruar që po ndiejnë stres të konsiderueshëm për shkak të testimit. Mirëqenia psikike po aq sa ajo fizike është e një rëndësie të veçantë për secilin/ën nxënës/e sidomos në situata kaotike dhe vet-stresuese siç është situata e krijuar nga Covid-19. Kandidatët/et si respondentë/e në **51.3% tē rasteve kosniderojnë se e kanë pasur të vështirë të kontrollojnë stresin**, përderisa **13.9% këtë mendojnë** që kjo deklaratë **nuk është aspak e vërtetë** për ta.



Figura 37. Deklarata e respondentëve (1-5): E kam pasur të vështirë të menaxhoj stresin

4.3.14 Jam shqetësuar vazhdimisht për faktin se do infektohem me virus nga prania në testim

Covid-19 si virus dhe ndryshimi i shpeshtë i masave kufizuese për para-ndalim - qeveritare ka ndikuar dhe panikën, frikën dhe mirëqenien e kandidatëve/eve të provimit të maturës

RAPORT PËRMBLEDHËS I MONITORIMIT I PROVIMIT TË MATURËS SHTETËRORE

shtetërore, dhe të gjithë nxënësve përgjithësisht. Referuar bazës ligjore dhe sugjerimeve, MASH si institucion ka organizuar procesin e Provimit të Maturës Shtetërore, në kohë kritike të infektimeve dhe rrezikut për infektim. Në **33% të rasteve nxënësit konsiderojnë deklaratën si shumë të vërtetë apo deklarojnë se kanë qenë të shqetësuar për faktin se do infektohen me virus përderisa një numër poashtu i madh **29.7% i respondentëve theksojnë që nuk kanë qenë të shqetësuar apo që aspak nuk pajtohen me këtë deklaratë.****



Figura 38. Deklarata e respondentëve (1-5): Jam shqetësuar vazhdimisht për faktin se do marrë virusin

Rekomandime

1. Ligji Nr. 05/L – 018 Për Provimin e Maturës Shtetërore dhe aktet nën-ligjore që rrjedhin prej ti të zbatohen me plotëfuqishëmri nga secila palë e përfshirë në proces;
2. Institucionet relevante si MASH, të gjej dhe ofroj mekanizma përkatës për zbatim të ligjmërisë, përfshirë këtu inspektim të punës së terrenit dhe ndërmarrjes së masave të nevojshme sipas dispozitave sanksionuese;
3. MASH, KQSHM dhe DVSM si dhe institucionet e tjera gjegjëse të informojnë me kohë të gjitha palët e përfshirë në proces, me theks të veçantë kandidati/ja, për tërë procedurat, metodat dhe procesin e Provimit të Maturës Shtetërore;
4. Administruesit/et, Mbikëqyrësit dhe Kryetarët e Komisionit, duhet të jenë mirë të informuar mbi procesin, të veprojnë me pikëmëri dhe të sanksionohen në rast të mos-respektimit të rregullave. Masa edhe më të shtrënguara duhet të ndërmerren për palët që lejojnë apo ndihmojnë fenomenin e kopjimit apo bashkëpunimit;
5. Të ndalohet dhe menaxhohet në çdo formë të tij kopimi dhe bashkëpunimi;
6. Të ndërmerren masa e nevojshme, për kandidatët/et që nuk respektojnë rregullat e Provimit të Maturës Shtetërore. Masa edhe më të shtrënguara duhet të ndërmerren për kandidatët/et që kopjojnë apo bashkëpunojnë;
7. Të eliminohen problemet teknike, përfshirë këtu: Gabimet në teste, gabimet në lista të kandidatëve/eve, dhe gabimet në përzgjedhje të lëndëve zgjedhore nga kandidatët/et;
8. Kandidatëve duhet të ju mundësohet në çdo rr Ethanë para-përgatitja për Provimit e Maturës Shtetërore, apo më saktësisht njohja me procesin;
9. Provimi i Maturës Shtetërore – rekomandohet të digjitalizohet. Rrethanat kaotike të krijuara, siç ishte kjo e vitit 2020 – pandemia Covid -19, por jo vetëm – argumentojnë nevojën për krijim të një procesi më të sofistikuar, të qasshëm për të gjithë, të lehtë në përdorim dhe të pamundshëm për keqpërdorim.

Listë e dokumenteve të referencës

1. Minstria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, Ligji Nr. 04/L-032 Për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, GAZETA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS / Nr. 2 /2016, PRISHTINË.
2. Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Udhëzim Administrativ (MASHT) nr.04/2016,D Detyrat dhe Përgjegjësitet e Komisionit në Qendrat e Testimit, Kabineti i Ministrat, 2016, Prishtinë.
3. Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Udhëzim Administrativ (MASHT) nr.05/2016,D Detyrat dhe Përgjegjësitet e Administruesit dhe Mbikëqyrësit gjatë procesit të Administrimit të Provimit të Maturës Shtetërore, Kabineti i Ministrat, 2016, Prishtinë.
4. Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Udhëzues për Maturën Shtetërore, 2020, Prishtinë
5. Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Informata, Udhëzime dhe Rregulla për Kandidatët (Maturantët) për Provimin e Maturës Shtetërore 2020, Komisioni Shtetëror i Maturës,2020, Prishtinë.
6. Ministria e Arsimit dhe Shkencës, nr. 01-12 Vendim për Shtyerjen e afatit të testit të arritshmërisë dhe testit të maturës shtetërore, Kabineti i Ministrat, 2020, Prishtinë.
7. Qeveria e Republikës së Kosovës, nr.01/07 Vendim: Parandalimi i infeksionit Corona Virus COVID-19, 2020, Prishtinë.
8. Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Udhëzime për Drejtoretë Komunale të Arsimit për Realizimin e Mësimit Online për Shkollat e Mesme të Larta (SHML), 2020, Prishtinë.
9. Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Nr.25/01B, Vendim: për Procedurat e realizimit të vlerësimit të nxënësve gjatë mësimit në distancë, në të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar në Kosovë, Kabineti i Ministrat, 2020, Prishtinë.

Formularët

Provimi i maturës shtetërore 2020

Të nderuar nxënës, ky është një hulumtim i cili realizohet nga Këshilli i Nxënësve të Kosovës - KNK që funksionon nën ombrellën e Këshillit Rinor Kosovar - KYC. Pyetësori ka për qëllim të kuptojë gatishmërinë dhe nivelin përgatitjes së nxënësve për Provimin e Maturës Shtetërore, si dhe të kuptojë më mirë sfidat e mësimit të zhvilluar online.

E rëndësishme të ceket që përgjigjet janë anonte dhe të gjitha të dhënat janë konfidenciale dhe do të përdoren vetëm për qëllimin e këtij hulumtimi.

1	Gjinia
a)	Vajzë
b)	Djalë
c)	Tjetër
2	Mosha
3	Komuna
4	A do ti nënshtroheni Provimit të Maturës Shtetërore këtë vit?
a)	PO
b)	JO
5	Sa ndjeheni të përgatitur për të ju nënshtuar Provimit të Maturës Shtetërore?
a)	Plotësisht i/e përgatitut
b)	Mesatarisht i/e përgatitut
c)	Deri diku i/e përgatitut
d)	Aspak i/e përgatitut
6	A ndiheni i/e stresuar për Provimin e Maturës Shtetërore?
a)	Shumë i/e stresuar
b)	Deri diku i/e stresuar
c)	Pak i/e stresuar
d)	Aspak i/e stresuar

7 A keni pasur informacione nga shkolla juaj në lidhje me procedurën e plotësimit dhe organizimit të Provimit të Maturës Shtetërore?

- a) Po
- b) Deri diku
- c) Jo
- d) E kam lexuar udhëzuesin e nxjerrur nga MASHTI

8 A keni pasur përgatitje nga mësimdhënësit, gjatë vtitit shkollor, për Provimin e Maturës Shtetërore?

- a) Po
- b) Deri diku
- c) Jo

9 A keni filluar të mbanit parapërgatitje online për Provimin e Maturës Shtetërore?

- a) PO
- b) JO

10 Sa minuta zgjat një orë përgatitore (mesatarisht) për Provimin e Maturës të cilën e mbanit online me mësimdhënësit e shkollës tuaj?

11 A jeni duke mbajtur parapërgatitje online për secilën lëndë mësimore që do të përfshihet në Provimin e Maturës Shtetërore?

- a) Vetëm për një (1) lëndë mësimore
- b) Për dy (2) lëndë mësimore
- c) Për tri (3) lëndë mësimore
- d) Për katër (4) lëndë mësimore

12 Sa janë efektive parapërgatitjet për Provimin Shtetëror të Maturës të cilat i ndjekni online?

- | | |
|----|--------------------|
| a) | Shumë efektive |
| b) | Deri diku efektive |
| c) | Aspak efektive |

MËSIMI ONLINE

13 A e keni ndjekur mësimin online?

- | | |
|----|----|
| a) | PO |
| b) | JO |

14 Sa shpesh e keni ndjekur mësimin online?

- | | |
|----|---------------------------------------|
| a) | Kam ndjekur shumë pak orë mësimore |
| b) | Kam ndjekur disa orë mësimore |
| c) | Kam ndjekur shumicën e orëve mësimore |
| d) | Kam ndjekur të gjitha orët mësimore |

15 Sa ka qenë efektiv mësimi që e keni mbajtur online?

- | | |
|----|-------------------|
| a) | Aspak efektiv |
| b) | Deri diku efektiv |
| c) | Shumë efektiv |

16 A i keni mbajtur lëndët zgjedhore online?

- | | |
|----|---------------|
| a) | Asnjëherë |
| b) | Disa herë |
| c) | Po, në tërësi |

17 A keni pasur problem me procesin e qasjes në platformat online për të mbajtur mësimin?

- | | |
|----|-----------------------------|
| a) | Po, kam pasur shumë problem |
| b) | Jo dhe aq |
| c) | Aspak problem |

18 Ju lutem përgjigjuni se sa janë të vërteta/pavërteta për ju deklaratat në vijim:

18.1 Unë njoh një shok/shoqe i/e cili/a nuk ka mundur të ndjek mësimin online shkaku i mungesës së paisjeve teknologjike.

- | | |
|----|------------------------|
| a) | Plotësisht e vërtetë |
| b) | Deri diku e vërtetë |
| c) | Nuk aplikohet |
| d) | Deri diku e pavërtetë |
| e) | Plotësisht e pavërtetë |

18.2 Jam zgjuar në mëngjes ndonjëherë për të konfirmuar pjesmarrjen në mësimin online, dhe pastaj kam vazhduar gjumin apo ndonjë aktivitet tjeter.

- | | |
|----|------------------------|
| a) | Plotësisht e vërtetë |
| b) | Deri diku e vërtetë |
| c) | Nuk aplikohet |
| d) | Deri diku e pavërtetë |
| e) | Plotësisht e pavërtetë |

18.3 Unë mendoj që mësimdhënësit kanë qenë të përgatitur për të dhënë mësimin në platforma online.

- | | |
|----|------------------------|
| a) | Plotësisht e vërtetë |
| b) | Deri diku e vërtetë |
| c) | Nuk aplikohet |
| d) | Deri diku e pavërtetë |
| e) | Plotësisht e pavërtetë |

Forma e raportimit të monitoruesit/es të maturës

1	Komuna ku mbahet testimi		
2	Emri Mbiemri i monitoruesit/es		
3	Emri i shkollës ku monitorohet		
4	Qendra numër:		
5	Koha e nisjes nga MASH		
6	Koha e arritjes në qendrën e testimit		
7	Qendra ishte e përgaditur?	PO	JO
8	Nëse jo, PSE?		
9	Koha e futjes së nxënësve në qendër:		
10	A ka rekomanduar para hyrjes drejtori me kryetarin e komisionit largimin e telefonave dhe mjeteve tjera elekronike?	PO	JO
11	Nëse jo, PSE?		
12	Koha e fillimit të testimit		
13	A kishte shkelje gjatë testimit?	PO	JO
14	Nëse PO, shkruani se çfarë shkelje?		
15	A kishte largim të nxënësve apo administruesve?	PO	JO
16	Nëse po, cila ishte arsyja, sa nxënës janë larguar?		
17	A pati hyrje të nxënësve pas fillimit të testit?	PO	JO
18	Koha e mbarimit të testimit		
19	Koha e kthimit në MASH		
20	Ju lutem përshkruani me fjalë gjithë mbarëvajtjen e testimit		
21	Data		

Këndvështrimi i maturantëve/provimi shtetëror i maturës 2020

Të dashur maturantë,

Këshilli Rinor Kosovar është organizatë jo-qeveritare që mision ka përmirësimin e edukimit në vend. Në vazhdën e punës për arritjen e misionit, është monitoruar mbarëvajtja e Provimit të Maturës Shtetërore 2020, dhe në këtë linjë po zhvillojmë këtë hulumtim, me synimin të kuptojmë se çfarë ndodhë nga perspektiva juaj në klasë gjatë mbajtjes së testit, dhe cilat janë qëndrimet e juaja në lidhje me mbarëvajtjen e Provimit të Maturës.

Këndvështrimi yt është thelbësor për krijimin e rekomandimeve dhe ngritjes së zërit të nxënësve, prandaj ju lusim të plotësoni këtë pyetësor në formën më reale.

Pyetësori është anonim, të dhënat do të përdoren vetëm për çështje hulumtuese, dhe informatat e juaja do të zhduken në publikim të raportit

SUKSESE!

1 Komuna												
2 Shkolla												
a)	Gjimnaz											
b)	Shkollë profesionale											
Në deklaratat në vijim ju lutem të përgjigjeni nga 1 (aspak e vërtetë) deri në 5 (shumë e vërtetë) duke u bazuar në atë se çfarë mendoni dhe ndjeni.												
Ndjej se kam pasur informata të sakta dhe në kohë rreth mbajtjes së testit të maturës.												
Aspak e vërtetë	1	2	3	4	5	Shumë e vërtet						
Pyetjet në test kanë qenë në përputhje me planprogramin mësimor.												
Aspak e vërtetë	1	2	3	4	5	Shumë e vërtet						
Konsideroj se ambienti i mbajtjes së testit ka qenë i përshtashëm.												
Aspak e vërtetë	1	2	3	4	5	Shumë e vërtet						

RAPORT PËRMBLEDHËS I MONITORIMIT I PROVIMIT TË MATURËS SHTETËRORE

Klasa/Hapësira ku është mbajtur testi ka qenë e dezinfektuar						
Aspak e vërtetë	1	2	3	4	5	Shumë e vërtet
Është respektuar distanca fizike mes nxënësve.						
Aspak e vërtetë	1	2	3	4	5	Shumë e vërtet
Sa nxënës ishit në klasën ku keni mbajtur testin?						
Aspak e vërtetë	1	2	3	4	5	Shumë e vërtet
Maskat janë mbajtur nga të gjithë nxënësit në klasë, gjatë tërë kohës.						
Aspak e vërtetë	1	2	3	4	5	Shumë e vërtet
Jam lejuar të bartë dhe përdorë telefonin me qëllim të arritjes së performancës më të mirë në test.						
Aspak e vërtetë	1	2	3	4	5	Shumë e vërtet
Stafi udhëheqës/monitorues ka qenë korrekt ndaj të gjithëve.						
Aspak e vërtetë	1	2	3	4	5	Shumë e vërtet
Jemi lejuar të bashkëpunojmë/kopjojmë me nxënësit e tjera në klasë						
Aspak e vërtetë	1	2	3	4	5	Shumë e vërtet
Administruesit i janë përmbajturi rregullave për maturën shtetërore si dhe udhëzimeve nga Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës.						
Aspak e vërtetë	1	2	3	4	5	Shumë e vërtet
Kam pasur vështirësi të kontrolloj stresin para dhe gjatë testit.						

RAPORT PËRMBLEDHËS I MONITORIMIT I PROVIMIT TË MATURËS SHTETËRORE

Aspak e vërtetë	1	2	3	4	5	Shumë e vërtet
Jam shqetësuar vazhdimisht për faktin se do marr virusin nga prania në atë klasë.						
Aspak e vërtetë	1	2	3	4	5	Shumë e vërtet
3 Cili është pragu i kalueshmërisë së testit?						
a)	60%					
b)	50%					
c)	40%					
4 A keni ndonjë koment/rekomandim rreth Provimit të Maturës Shtetërore 2020:						

Raportimet për testin e maturës

Të nderuar,

Këtu mund të raportoni në kohë reale problemet që po ndodhin, në mënyrë që të kemi një evidencë më të saktë.

Kjo nuk do të thotë që të njejtat info nuk duhet të përfshihen edhe në formën e raportimit që kemi.

1	Emri	
2	Komuna	
3	Qendra e testimit/shkolla	
4	Kategoria e problemit	
a)	Zhurmë	
b)	Ambienti	
c)	Përdorim telefoni	
d)	Kopjim	
e)	Probleme me administrues	
f)	Mungesë e testeve	
g)	Distanca sociale	
h)	Ndikim familjar	
5	Problemi	

